

**Rekomandimi CM/Rec
(2011) 7 i Komitetit të
Ministrave për shtetet
anëtare mbi një nocion
të ri të medias**



REKOMANDIMI CM/REC(2011)7
I KOMITETIT TË MINISTRAVE PËR SHTETET ANËTARE
MBI NJË NOCION TË RI TË MEDIAS

**(Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 21 shtator 2011
në takimin e 1121-të të zëvendës ministrave)**

Qëllimi i mediave

1. Që nga shfaqja e tyre si mjet i komunikimit masiv, mediat kanë qenë mjeti më i rëndësishëm për lirinë e shprehjes në sferën publike, duke bërë të mundur që njerëzit të ushtrojnë të drejtën e tyre për të kërkuar dhe marrë informacion. Mediat gjallërojnë dhe sigurojnë një hapësirë për debat publik. Mediat ofrojnë komente dhe opinione si pjesë e dialogut politik, kontribuojnë në përcaktimin e agjendës politike dhe formësimin e opinionit publik, dhe shpesh kërkojnë të promovojnë vlera të caktuara. Mediat lehtësojnë shqyrtimin e çështjeve publike dhe politike dhe atyre private apo të lidhura me biznesin, duke rritur transparencën dhe llogaridhënien. Për më tepër, mediat sigurojnë edukim, argëtim, shprehje kulturore dhe artistike. Mediat luajnë edhe një rol të rëndësishëm në ekonomi, krijojnë vende pune dhe gjenerojnë të ardhura.

Media dhe demokracia

2. Liria e shprehjes, në veçanti e drejta për të kërkuar, dhënë dhe marrë informacion, dhe liria e medias e lidhur me të, janë të domosdoshme për demokraci të mirëfilltë dhe procese demokratike. Në një shoqëri demokratike, njerëzit duhet të jenë në gjendje të kontribuojnë dhe të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse që i shqetësojnë ata. Kjo vlen për modelet e qeverisjes lokale, kombëtare ose ndërkombëtare, si dhe të komuniteteve të tjera të veçanta. Në këtë kontekst, qeverisja demokratike duhet të kuptohet në terma të gjerë për të përfshirë proceset që kanë të bëjnë me çështje private apo të lidhura me biznesin me rëndësi për politikën publike ose interesin kolektiv. E gjithë përmbajtja e siguruar nga media ka ndikim potencial në shoqëri pavarësisht nga vlera që i atribuohet. Fuqia e mediave mund të keqpërdoret, sidomos në një kontekst të përqendrimit të fuqishëm të mediave, në dëm të pluralizmit dhe demokracisë.

Standardet dhe rregullimi i mediave

3. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë marrë përsipër t'u sigurojnë të gjithëve brenda juridiksionit të tyre të drejtën themelore të lirisë së shprehjes dhe informacionit, në përputhje me Nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("Konventa", ETS Nr. 5). Kjo e drejtë nuk është absolute; ajo mbart detyra dhe përgjegjësi dhe mund të jetë subjekt i kufizimeve në përputhje me nenin 10, paragrafi 2, të Konventës.

4. Historikisht, rregullimi i mediave është justifikuar dhe vendosur duke pasur parasysh ndikimin e mundshëm të lartë në shoqëri dhe në të drejtat individuale; rregullimi ka qenë gjithashtu një mjet i menaxhimit në interes të publikut të resurseve të pakta. Duke pasur parasysh rëndësinë e tyre për demokracinë, media ka qenë subjekt i aktiviteteve të gjerë të përcaktimit të standardeve të Këshillit të Evropës. Qëllimi ka qenë sigurimi i mbrojtjes më të lartë të lirisë së medias dhe ofrimi i udhëzimeve mbi detyrat dhe përgjegjësitë. Çdo rregullore, si një formë e ndërhyrjes, duhet të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe standardet që burojnë nga jurisprudenca përkatëse e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Zhvillimet në ekosistemin e mediave

5. Zhvillimet në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit dhe aplikimi i tyre në komunikimin masiv kanë çuar në ndryshime të rëndësishme në ekosistemin e mediave, që në terma të gjerë përfshin të gjithë aktorët dhe faktorët bashkëveprimi i të cilëve u lejon mediave që të funksionojnë dhe të përmbushin rolin e tyre në shoqëri. Ky mjedis ka lejuar mënyra të reja të shpërndarjes së përmbajtjes në një shkallë të madhe dhe shpesh me kosto mjaft më të ulët dhe

me më pak kërkesa teknike dhe profesionale. Tiparet e reja përfshijnë nivele të papara të ndërveprimit dhe angazhimit nga ana e përdoruesit, duke ofruar mundësi të reja për qytetarinë demokratike. Aplikacionet e reja lehtësojnë pjesëmarrjen e përdoruesve në procesin e krijimit dhe përhapjes së informacionit dhe përmbajtjes, duke megjulluar kufijtë midis komunikimit publik dhe privat. Praktikrat e brendshme redaktoriale të mediave kanë ndryshuar, duke adoptuar modalitete, procedura dhe rezultate të reja.

6. Me këto ndryshime në ekosistemin e mediave, funksionimi dhe ekzistenca e aktorëve tradicionale të mediave, si dhe modelet e tyre ekonomike dhe standardet profesionale, janë duke u plotësuar ose zëvendësuar nga aktorë të tjerë. Aktorët e rinj kanë marrë përsipër funksione në procesin e prodhimit dhe të shpërndarjes së shërbimeve mediatike që deri kohët e fundit janë kryer vetëm (ose kryesisht) nga organizata tradicionale të mediave; këto përfshijnë mbledhës të përmbajtjes, projektues të aplikacionit dhe përdorues të cilët janë edhe prodhuesit e përmbajtjes. Një numër i “ndërmjetësve” ose “ndihmësve”, të cilët shpesh dalin nga sektori (TIK) i informacionit dhe komunikimit, duke përfshirë ata që shërbejnë në fillim thjeshtë si përçues (për shembull infrastruktura, operatorët e rrjetit apo platformës), janë thelbësorë për shtrirjen e mediave digjitale në terren dhe qasjen e njerëzve në to. Shërbimet e ofruara nga këta aktorë të rinj janë kthyer në zbulues të pastër të informacionit, dhe me raste i kthejnë ndërmjetësit apo ndihmësit në rojtarë informacioni ose lojtarë që marrin përsipër një rol aktiv në proceset redaktoriale të komunikimit masiv. Shërbime të tilla kanë plotësuar ose, në disa raste, pjesërisht i kanë zëvendësuar aktorët tradicionalë të mediave në lidhje me ato funksione. Rolet e secilit aktor mund të ndryshojnë ose të zhvillohen në mënyrë fluide dhe pa pengesa. Për më tepër, disa kanë zhvilluar shërbime ose aplikacione të cilat i kanë vënë në një pozitë dominuese në nivel kombëtar apo edhe në nivel global.

Një nocion i ri i mediave që kërkon një përjasje të shkallëzuar dhe të diferencuar

7. Pavarësisht ndryshimeve në ekosistemin mediatik, roli i mediave në një shoqëri demokratike, edhe pse me mjete shitesë (domethënë bashkëveprim dhe

angazhim), nuk ka ndryshuar. Politika e lidhur me mediat duhet pra të marrë parasysh këto zhvillime dhe ato që priten, duke përqafuar një nocion të mediave që është i përshtatshëm për një realitet të tillë fluid dhe shumë-dimensional. Të gjithë aktorëve - qofshin të rinj apo tradicionalë - që veprojnë në kuadër të ekosistemit të mediave duhet t’u ofrohet një kuadër politikash që garanton një nivel të duhur të mbrojtjes dhe siguron tregues të qartë të detyrave dhe përgjegjësi të tyre në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës. Përgjigja duhet të shkallëzohet dhe të diferencohet sipas pjesës që luajnë shërbimet e mediave në proceset e prodhimit dhe shpërndarjes së përmbajtjes. Vëmendje i duhet kushtuar edhe formave të mundshme të ndërhyrjes në funksionimin e duhur të medias apo të ekosistemit të saj, duke përfshirë edhe veprimin indirekt kundër infrastrukturës ekonomike apo operacional të medias.

Komiteti i Ministrave, sipas termave të nenit 15. b të Statutit të Këshillit të Evropës rekomandon që shtetet anëtare:

- **të miratojnë një nocion të ri, të gjerë të mediave** që përfshin të gjithë aktorët e përfshirë në prodhimin dhe shpërndarjen e përmbajtjes për numër potencialisht të lartë të njerëzve (për shembull informacion, analiza, komente, opinione, edukim, kulturë, art dhe argëtim në formë të shkruar, audio, vizuale, ose formë tjetër) dhe aplikacionet të cilat janë projektuar për të lehtësuar komunikimin interaktiv masiv (për shembull, rrjetet sociale) ose përvoja të tjera ndërvepruese të bazuara në përmbajtje dhe në shkallë të gjerë (për shembull lojërat në rrjet), duke ruajtur (në të gjitha këto raste) kontrolli redaktorial ose mbikëqyrjen e përmbajtjes;

- **të shqyrtojnë nevojat rregullatore në lidhje me të gjithë aktorët** që ofrojnë shërbime ose produkte në ekosistemin e mediave, në mënyrë që të garantojnë të drejtën e njerëzve për të kërkuar, marrë dhe shpërndarë informacion në përputhje me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe për t’u ofruar këtyre aktorëve masat mbrojtëse përkatëse kundër ndërhyrjeve që përndryshe mund të kenë një efekt negativ në të drejtat e

nenit 10, duke përfshirë situatat që rrezikojnë të çojnë në vetëpërmbytjes ose vetëcensurë të panevojshme;

- të zbatojnë kriteret e përcaktuara në shtojcën e këtij dokumenti, kur shqyrtojnë një përgjigje të shkallëzuar dhe të diferencuar për aktorët që bëjnë pjesë në nocionin e ri të mediave, bazuar në standardet përkatëse të lidhura me mediat të Këshillit të Evropës, duke pasur parasysh funksionet e tyre specifike në procesin mediatik dhe ndikimin potencial e rëndësishëm të tyre në sigurimin apo përmirësimin e qeverisjes së mirë në një shoqëri demokratike;

- të angazhohen në dialog me të gjithë aktorët në ekosistemin e mediave në mënyrë që të jenë të informuar siç duhet për kuadrin ligjor në fuqi; të ftojnë mediat tradicionale dhe të reja për të shkëmbyer praktikën e mira dhe, nëse është e përshtatshme, të konsultohen me njëri-tjetrin në mënyrë që të zhvillojnë mjete vetë-rregulluese, duke përfshirë edhe kodet e mirësjelljes, të cilat marrin parasysh, ose përfshijnë në një formë të përshtatshme, standardet e pranuar përgjithësisht të me-

diave e gazetarisë;

- të adoptojnë strategji për të nxitur, zhvilluar apo siguruar nivele të përshtatshme të ofrimit të shërbimeve publike në mënyrë që të garantojnë një nivel të kënaqshëm të pluralizmit, shumëllojshmërinë e përmbytjes dhe zgjedhjen e konsumatorit dhe për të siguruar shqyrtim nga afër ose monitorim të zhvillimeve;

- të mbeten të vëmendshëm për të adresuar situatat e koncentrimin të fortë në ekosistemin e mediave që mund të rezultojnë në keqpërdorimin e aftësisë së një aktori për të krijuar ose ndikuar mbi opinionin publik apo zgjedhjet e njerëzve me pasoja potencialisht negative në lidhje me qeverisjen dhe, më veçanërisht, pluralizmin politik dhe proceset demokratike, sidomos teksa lloje të reja të shërbimeve, aplikacioneve apo platformave kanë fituar rëndësi në këto drejtime;

- të ndërmarrin veprime, individualisht ose kolektivisht, për të promovuar këto përjasje në forumet përkatëse ndërkombëtare.

SHTOJCA E REKOMANDIMIT CM/REC(2011)7

Kriteret për identifikimin e mediave dhe udhëzimet për një përgjigje të shkallëzuar dhe të diferencuar

HYRJE

1. Demokracia dhe liria e shprehjes kërkojnë nga shtetet anëtare që të përmbahen nga ndërhyrje të panevojshme mbi mediat. Shtetet anëtare duhet gjithashtu të marrin masa proaktive për të promovuar lirinë, pavarësinë, pluralizmin dhe diversitetin e mediave dhe për të mbrojtur aktivitetet që sigurojnë funksionimin e përshtatshëm të ekosistemit të mediave, i kuptuar në terma të gjerë që përfshijnë të gjithë aktorët dhe faktorët bashkëveprimi i të cilëve u lejon mediave të funksionojë dhe të përmbushin rolin e tyre në shoqëri.

2. Kuadri i politikës së vendosur duhet të jetë i qartë dhe pasojat e aplikimit të saj duhet të jenë të parashikueshme. Kuadri duhet të artikulohet në drejtim të mbrojtjes dhe promovimit të lirisë së shprehjes, diversitetit dhe pluralizmit, dhe duhet të identifikojë detyrat dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve në ekosistemin e mediave, duke iu nënshtruar limiteve strikte të përcaktuara në nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, siç në jurisprudencën përkatëse të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

3. Hartimi i politikave dhe sidomos proceset rregullatore duhet të sigurohen që i kushtohet vëmendja e duhur parimit që çdo rregullorë, si formë e ndërhyrjes, duhet të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe standardet që burojnë nga jurisprudenca përkatëse e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Prandaj, përgjigjet rregullatore duhet t'i përgjigjen një nevojë të ngutshme sociale dhe, duke pasur parasysh ndikimin e tyre të prekshëm, ato duhet të jenë proporcionale me qëllimin e synuar.

4. Këshilli i Evropës ka zhvilluar gjatë viteve një gamë domethënëse të standardeve në lidhje me mediat, në mënyrë që të ndihmojë hartuesit e politikave të mediave në përpjekjet e tyre të nevojshme për t'u ofruar mediave mbrojtjen që u nevojitet për funksionimin e tyre të duhur, dhe në aktivitetet e tyre rregullatore dhe të lidhura me hartimin e politikave. Në mënyrë që të ndihmojnë shtetet anëtare në zbatimin e Rekomandimit mbi një nocion i ri të mediave, udhëzimi është propozuar në këtë shtojcë, nga njëra anë për të lehtësuar kuptimin

nëse aktivitete, shërbime apo aktorë të veçantë mund të kategorizohen si media (Pjesa I) dhe, nga ana tjetër, për të frymëzuar një përqasje të shkallëzuar dhe të diferencuar të politikave në lidhje me aktivitete, shërbime apo aktorë të ndryshëm që janë pjesë e ekosistemit të mediave (Pjesa II).

5. Rezultati i shqyrtimit të aktiviteteve, shërbimeve ose aktorëve nën dritën e kriterëve (dhe treguesve) duhet të ndihmojë në matjen e nevojës dhe shkallës së hartimit të politikës apo nevojave rregullatore si dhe në shkallën e zbatimit të kornizave përkatëse ligjore (sa i përket lirive dhe përgjegjësi). Për shembull, përgjigjet e politikave ndaj mediave të fokusuara në shërbime të lajmeve mund të ndryshojnë për ato që ofrojnë një platformë për debat politik apo argëtim, të cilat nga ana tjetër ndryshojnë nga shoqërimi i thjeshtë i aktiviteteve gjeneruese të të ardhurave meshpërndarjen e përmbajtjes përmes mjeteve të komunikimit masiv.

6. Për këtë qëllim, bazuar në standardet ekzistuese të Këshillit të Evropës, Pjesa II ofron udhëzime për krijuesit e politikave si t'i zbatojnë standardet e mediave në aktivitete të reja të mediave, shërbimeve ose aktorëve. Po ashtu, ofron mundësinë për të adresuar ose përforcuar perspektivën e barazisë gjinore në përgjigje të thirrjes së bërë nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës në Deklaratën e Madridit "Kthimi i barazisë gjinore në realitet" (12 maj 2009) dhe thirrjes së bërë në raportin e Grupit të personave të shquar me titull "Të jetojmë së bashku. Kombinimi i diversitetin dhe lirisë në Evropën e shekullit 21", i paraqitur para Komitetit të Ministrave në Stamboll më 10 maj 2011.

7. Përqasja e diferencuar dhe përshkallëzuar kërkon që secili aktor, shërbimet e të cilit janë identifikuar si media apo si aktivitet ndërmjetës apo ndihmës, të përfitojë si nga forma e duhur (e diferencuar) ashtu dhe nga niveli i duhur (i përshkallëzuar) i mbrojtjes, dhe që përgjegjësi të përvijohet në përputhje me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe standardet e tjera përkatëse të zhvilluara nga Këshilli i Evropës.

8. Po ashtu, duhet të përmendim se metodat më të reja ose në zhvillim të përhapjes masive të përmbajtjes dhe, mbajtja, përpunimi dhe shfrytëzimi i të dhënave, mund të ndikojnë në të drejtat e mbrojtura në bazë të nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

PJESA I - KRITERET DHE TREGUESIT E MEDIAVE

KOMENTE PARAPRAKE

9. Politikëbërësit e mediave ftohen që të marrin parasysh kriteret në vijim kur shqyrtojnë nëse aktivitetet, shërbimet ose aktorët e veçantë duhet të konsiderohen si media.

10. Më poshtë, janë të përcaktuara gjashtë kritere, secili i plotësuar me një sërë treguesish, që duhet t'u lejojnë krijuesve të politikave identifikimin e mediave dhe veprimtarive mediatike në ekosistemin e ri. Shkalla e plotësimit të kriterëve lejon që të përcaktohet nëse një shërbim i ri komunikimi përbën një medium ose do të japë një tregues të aktiviteteve të ndërmjetësisht ose ndihmës për shërbimet mediatike. Treguesit duhet të lejojnë vlerësimin e shkallës së plotësimit të një kriteri të caktuar. Jo të gjithë treguesit duhet të plotësohen për të përmbushur një kriter të veçantë. Disa tregues, siç janë ato që lidhen me standardet profesionale dhe etikën e mediave, kanë të bëjnë me më shumë se një kriter.

11. Në mënyrë të ngjashme, jo të gjitha kriteret kanë peshë të barabartë. Mungesa e kriterëve të caktuar, si qëllimi (kriteri 2), kontrolli redaktorial (kriteri 3) ose shtrirja dhe shpërndarja (kriteri 5) priren që ta skualifikojnë një shërbim nga të qenit i konsideruar si media. Disa kritere, të tilla si synimi (kriteri 1) ose pritshmëria publike (kriteri 6), mund të mos plotësohen apo të mos jenë menjëherë të dukshme, çka nuk duhet automatikisht ta ndalojë konsiderimin si media të një shërbimi, por mund të kenë peshë të konsiderueshme në qoftë se janë të pranishëm.

12. Kur shqyrtohen kriteret, duhet të merren parasysh karakteristikat dhe tiparet përkatëse të ofruesit të shërbimeve, si dhe procesi i maturimit si media i ofruesit të shërbimeve, çka mund të ketë një ndikim në mënyrën e shfaqjes së kontrollit redaktorial (kriteri 3) ose në profesionalizmin e vetë-perceptuar (kriteri 4). Rrjedhimisht, të gjitha kriteret (dhe treguesit) duhet të zbatohen me fleksibilitet, duke i interpretuar në kontekstin e situatave ose realiteteve të veçanta. Në mjediset e reja të komunikimit kërkohet vëmendje e vazhdueshme, pasi roli dhe funksionimi i një aktorit mund të ndryshojë lehtë dhe të zhvillo-

het në formë të rrjedhshme dhe natyrale, çka mund të ndikojë mbi shkallën në të cilën janë përmbushur një ose më shumë kritere dhe në këtë mënyrë mbi klasifikimin e tij të mundshëm si media.

13. Një tipar përgjithësisht i pranuar i mediave është roli i tyre në shoqëri dhe ndikimi tyre në shoqëri ose mbi drejtimin e proceseve demokratike. Ndikimi mund të shihet si pjesë e disa prej kriterëve më poshtë. Megjithatë, duke pasur parasysh se vlerësimi i ndikimit është shumë subjektiv, ai nuk duhet të konsiderohet si faktor përcaktues. E gjithë përmbajtjet e siguruar nga media ka një ndikim potencial në shoqëri, pavarësisht nga madhësia e segmentit të popullsisë në fjalë, dhe pavarësisht nga vlera që i atribuohet atij nga shoqëria si një e tërë.

14. Rezultati i kësaj analize duhet të merret parasysh kur formësohen politikat lidhur me mediat dhe kur përshkallezohet zbatimi i tyre, gjithmonë në lidhje me paralajmërime rreptësisht të domosdoshme dhe ndërhyrjes minimale. Po ashtu do të ketë ndikim në masën në të cilën zbatohen standardet e eKëshillit të Evropës për median dhe në modalitetet e zbatimit. Kjo nënkupton nevojën për një përgjigje fleksibël, të përshtatur për rastin konkret (domethënë e diferencuar) dhe shkallëzuar për qëllimin që ka. Përgjigja duhet gjithashtu të marrë parasysh karakteristikat dhe origjinalitetin e ofruesit të shërbimeve, si dhe procesin e maturimit si media të atij ofruesi të shërbimeve.

15. Ndërmjetësit dhe ndihmësit në ekosistemin e mediave mund të dallohen nga mediat, pasi ata mund të plotësojnë disa nga kriteret ose treguesit e mëposhtëm, por ata zakonisht nuk i përmbushin disa nga kriteret kryesore të tilla si kontrolli redaktorial (kriteri 3) ose qëllimi (Kriteri 2). Megjithatë, ata shpesh luajnë rol thelbësor, i cili mund t'u japë fuqi të konsiderueshme sa i përket shtrirjes dhe kontrollit apo mbikëqyrjes së përmbajtjes. Si rezultat, ndërmjetësit dhe ndihmësit mund të marrin me lehtësi një rol aktiv në proceset redaktoriale të komunikimit masiv. Shtetet anëtare duhet t'i konsiderojnë me kujdes në hartimin e politikave të lidhura me mediat dhe duhet të jenë veçanërisht të vëmendshëm ndaj obligimeve

të veta pozitive dhe negative që rrjedhin nga neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo mund të kërkojë një përgjigje të politikës së diferencuar (të përshtatur për ndërmjetës ose ndihmës të veçantë) që merr parasysh specifikat e situatës (për shembull kur veprimi i tyre mund të ketë ndikim mbi pluralizmin apo aftësinë e mediave, të shërbyera nga ndërmjetësit apo ndihmësit në fjalë, për të përmbyshur qëllimin e tyre, për të funksionuar normalisht ose për të vazhduar të ofrojnë shërbimet e tyre).



16. Vullneti i një aktori është faktor i rëndësishëm në vlerësimin nëse vetë aktori ose disa apo të gjitha shërbimet dhe produktet e tij duhet të konsiderohen si media. Kjo lejon edhe një shkallëzim të parë në diferencimin e politikave në bazë të perceptimeve personale të aktorëve të ndryshëm sa i përket aktiviteteve dhe shërbimeve të tyre.

17. Synimi për të vepruar si media mund të shprehet me mjete subjektive (për shembull nga vetë-deklarimi si media, vetë-etiketimi, brendi, deklarimi i një qëllimi, deklarata e misionit ose plani i biznesit që kanë qëllime mediatike apo gazetareske) dhe mund të jetë i qartë apo edhe formalisht i regjistruar (si në rastin e regjistrimit të biznesit, qëllimit të deklaruar në nenet e statutit të shoqatës). Këta tregues subjektive mund t'u referohen kritereve të tjera, të tillë si qëllimi (për shembull vendosmëria për të dhënë lajme të përditësuara rregullisht), kontrolli redaktorial ose standardet profesionale.

18. Më veçanërisht, synimi mund të zbulohet me anë të adoptimit të politikës redaktoriale apo angazhimit për standardet profesionale dhe etike të cilat janë tipike për mediat. Një politikë apo angazhim redaktorial gjithashtu mund të shprehet në afatet dhe kushtet e përdorimit të cilat ofrojnë shpjegime për përdoruesit e një shërbimi në lidhje me llojet e përmbajtjes apo sjelljet e pranura ose jo nga operatori.

19. Mund të jetë me rëndësi edhe anëtarësimi në organizata profesionale mediatike ose organizata profesionale, të cilat promovojnë ose zbatojnë kodet e etikës ose të praktikës së mirë, ose angazhohen në forma të tjera të vetë-rregullimit tipike për media, , si dhe zgjedhja e personelit (për shembull gazetarët) për funksione të caktuara, përshkrimet e punës së personelit, trajnimet apo edhe zgjedhja e sigurimit profesional (për shembull kundër shpifjes).

20. Synimi mund të nxirret edhe nga veprimet e ndërmarra (për shembull ngritja e një biznesi ose platforme dhe punësimi i personelit, etj.) për të prodhuar ose shpërndarë në një audiencë të gjerë përmbajtjen tipike të mediave (për shembull informacion, analiza, komente, opinione, edukim, kulturë, art dhe argëtim në formë tekstuale, audio, vizuale, dhe audio-vizuale).

21. Në një mjedis të ri të komunikimit, synimi shtrihet në veprimet e ndërmarra për të rregulluar, mbledhur ose zgjedhur (për shembull me anë të algoritmeve) dhe për të shpërndarë përmbajtjen e sipërpërmendur në një numër potencialisht të madh të njerëzve nëpërmjet mjeteve të komunikimit masiv. Shtrihet edhe në aplikacionet operative për hapësirat kolektive në rrjet, të cilat janë të dizajnuara për të lehtësuar komunikimin masiv interaktiv (ose komunikimin masiv në total) ose përvoja të tjera interaktive të bazuara në përmbajtje dhe në shkallë të gjerë. Synimi mund të evidentohet veçanërisht nga mjetet, marrëveshjet apo strukturat e vendosura për komunikim masiv (për shembull platformë ose gjerësi brezi që mundëson shtrirjen në masë).

22. Teksa synimi është një kriter i rëndësishëm në vetvete, ai nuk është i mjaftueshëm për ta konsideruar ose trajtuar një aktor apo ndonjë prej shërbimeve ose produkteve të tij si media.

KRITERI 2

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E THEMELORE TË MEDIAVE

Treguesit

- **Prodhimi, mbledhja ose shpërndarja e përmbajtjes mediatike**
- **Operimi i aplikacioneve apo platformave të dizajnuara për të lehtësuar komunikimin masiv interaktiv apo komunikim masiv në total (për shembull rrjetet sociale) dhe/ose për të siguruar përvoja interaktive të bazuara në përmbajtje në shkallë të gjerë (për shembull lojëra në rrjet)**
- **Me objektiva themelore si media (të gjallërohet dhe të sigurohet një hapësirë për debat publik dhe dialogu politik, të formësohet dhe ndikohet opinioni publik, të promovohen vlerat, të lehtësohet shqyrtimi dhe të rritet transparenca dhe llogaridhënia, të sigurohet edukim, argëtim, shprehje kulturore dhe artistike, të krijohen vende pune, të gjenerohen të ardhura - ose më shpesh, një kombinim i sa më lart)**
- **Rinovimi dhe përditësimi periodik i përmbajtjes**

23. Përkundër ndryshimeve në ekosistemin e mediave, qëllimi dhe objektivat themelore të mediave mbeten të pandryshuar në tërësi, përkatësisht ofrimi ose shpërndarja e përmbajtjes për një publik të gjerë dhe sigurimi i hapësirës për përvoja të ndryshme interaktive. Media janë mjeti më i rëndësishëm për lirinë e shprehjes.

24. Qëllimi dhe objektivat themelore të mediave mbeten faktorë përcaktues, veçanërisht për sa i përket rolit dhe ndikimit të tyre në shoqëri. Këto kanë qenë tipare të zgjedhura për identifikimin e mediave dhe janë shumë të rëndësishme për krijimin e proce-

seve të lidhura me mediat në hartimin e politikave dhe proceseve rregullatore. Pra, do të jenë një mjet i rëndësishëm kur të merret parasysh një përgjigje e diferencuar dhe e shkallëzuar.

25. Dëshira për të ndikuar opinionin publik, e cila ka qenë tradicionalisht një nga treguesit kryesorë për identifikimin e mediave apo veprimtarisë të lidhur me media, manifestohet duke u kushtuar përmbajtje çështjeve të debatit dhe interesit publik dhe në përpjekjet për të arritur një publik të gjerë. Dëshmia e ndikimit dhe efektit të tillë në shoqëri mund të rrjedhë nga kërkimet për besueshmërinë e medias dhe aftësinë e tyre për t'i arritur objektivat themelore të cilat janë të rëndësishme për proceset demokratike (shih në këtë kontekst kriteret 5 dhe 6, në lidhje me shtrirjen dhe shpërndarjen dhe pritshmërinë publike).

26. Mirëpo, gjykimet e vlerave në lidhje me përmbajtjen nuk duhet të jenë faktor përcaktues për të mos t'i quajtur media shërbimet, aktivitetet apo aktorët. Duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë rrezikut të përjashtimit të aktiviteteve të caktuara nga konsiderimi si media për shkak të modaliteteve të tyre inovative dhe jo nga tiparet e tyre thelbësore. Janë të rëndësishme edhe rregullimi, përmbledhja, zgjedhja ose, në disa raste, edhe promovimi i përmbajtjes për përhapjen më të gjerë. Në varësi të shkallës së plotësisht të kriterëve, nocioni i prodhuesit mund të duhet të dallohet nga mediat (për shembull në lidhje me platformat për ndarjen e përmbajtjes që i nënshtrohen kontrollit të lehtë redaktorial apo moderimit *pas postimit*). Në këtë drejtim mund të jenë të dobishme referenca për përmbajtjen interaktive të mediave tradicionale ose përmbajtjen e gjeneruar nga përdoruesi (për shembull bashkëpunim, pjesëmarrje e publikut, telefonata, formate quiz ose talk show). Kjo mund të ndikojë në shkallën dhe modalitetet e aplikimit të politikave të lidhur me mediat.

27. Nuk ka dyshim se modelet e reja të biznesit janë dhe do të vazhdojnë të zhvillohen për shoqërimin e aktiviteteve fitimprurëse me shpërndarjen e përmbajtjes. Kjo nganjëherë është në qendër të aktiviteteve të mediave dhe për këtë arsye mund të jetë e dobishme të identifikohen dhe kategorizohen shërbimet dhe veprimtaritë themelore të mediave dhe të merren në konsideratë politika dhe pasojat rregullatore.

28. Edhe rinovimi periodik ose i rregullt ose përditësimi i përmbajtjes duhen shqyrtuar si duhet. Ky tregues i mediave duhet të zbatohet me kujdes për shkak të rëndësinë së rinovimit të vazhdueshëm ose të rastit. Për më tepër, në një mjedis të ri të komunikimit ku përdoruesit ushtrojnë kontroll të konsiderueshëm mbi formësimin dhe kohën e qasjes në përmbajtje, përditësimi ose rinovimi mund të lidhen më ngushtë me përvojën e përdoruesit sesa me kohën apo përmbajtjen. Kjo vlen veçanërisht për shërbime që përfshijnë hapësira kolektive në rrjet të dizajnuara për të lehtësuar komunikim masiv interaktiv të bazuar në përmbajtje përmes bashkimeve ose përvojave interaktive në shkallë të gjerë.



29. Liria apo pavarësia redaktoriale është një kërkesë thelbësore për mediat dhe një rrjedhojë e drejtpërdrejtë e lirisë së shprehjes dhe e të drejtës për të pasur opinione dhe për të marrë dhe dhënë informacion, të garantuara në bazë të nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Një numër i standardeve ekzistuese të Këshillit të Evropës ofrojnë udhëzime të projektuara për të ruajtur dhe për të promovuar lirinë apo pavarësinë redaktoriale. Ana e kundërt e medaljes është kontrolli redaktorial apo mbikëqyrja e mediave mbi përmbajtjen dhe përgjegjësia për vendimet redaktoriale.

30. Kontrolli redaktorial mund të evidentohet nga vendimet politike të vetë aktorëve mbi përmbajtjen që vihet në dispozicion apo promovohet, dhe për mënyrën si paraqitet apo rregullohet. Mediat tradicionale ndonjëherë i bëjnë publicitet materialeve të shkruara në mënyrë eksplicite mbi politikat redaktoriale, por ato mund të gjenden edhe në udhëzimet

apo kriteret e brendshme për zgjedhje ose përpunim (për shembull verifikim apo vërtetim) të përmbajtjes. Në mjediset e reja të komunikimit, politikat redaktoriale mund të nguliten në deklaratat e misionit, ose në afatet dhe kushtet e përdorimit (të cilat mund të përmbajnë dispozita shumë të detajuara mbi përmbajtjen), ose mund të shprehen jozyrtarisht si një angazhim ndaj parimeve të caktuara (për shembull, mirësjellja në internet, motoja).

31. Mungesa e një deklarimi të kontrollit redaktorial nga media nuk duhet, në vetvete, të konsiderohet si një tregues i mungesës së tij. Procesi redaktorial përfshin një sërë rutinash dhe konventash që informojnë vendimmarrjen për sa i përket përmbajtjes. Në një mjedis mediatik në zhvillim, ka shumë shembuj të zhvillimit gradual dhe konsolidimit të procesit redaktorial teksa media arrin pjekurinë e saj. Siç ka ndodhur me mediat tradicionale, mund të ketë shakllë apo intensitet të ndryshueshëm të kontrollit mbi përmbajtjen, të cilat mund të perceptohen vetëm për sa i përket një pjese të vogël.

32. Procesi redaktorial mund të përfshijë përdoruesit (për shembull shqyrtimi i kolegëve dhe kërkesa për heqje të përmbajtjes) në vendimet përfundimtare të marra sipas një procesi të brendshëm të përcaktuar dhe që merr në konsideratë kriteret e specifikuar (moderim reaktiv). Mediat e reja shpesh mbështeten në moderim *pas postimit* (shpesh referohet si post-moderim) në lidhje me përmbajtjen e gjeneruar nga përdoruesit, i cili në shikim të parë mund të jetë i padukshëm. Proceset redaktoriale mund të jenë edhe të automatizuara (për shembull me algoritme *ex ante* që zgjedhin përmbajtjen apo krahasojnë përmbajtjen me materiale me të drejta të regjistruara të autorit).

33. Në raste të caktuara, kontrolli redaktorial mund të jetë më i dukshëm për sa i përket përmbajtjes së zgjedhur ose promovuar apo përmbajtjes së lidhur me aktivitetet e gjenerimit të të ardhurave (për shembull reklamat) sesa në lidhje me përmbajtje të tjera (për shembull materiale të krijuara nga përdoruesit). Nga ana tjetër, një pjesë e përmbajtjes (për shembull reklamat) mund të jetë nën kontrollin e drejtpërdrejtë të një pale të tretë, për arsye të një marrëveshjeje të agjencisë. Mediat tradicionale priren të përdorin kontroll redaktorial *ex ante* (ose para-moderim) lidhur me shërbime ose aktivitete të caktuara (për shembull me-

diat e shtypura ose disa transmetues), por jo të tjerat (për shembull ato bashkëpunuese, me pjesëmarrje të publikut, telefonata ose formate talk show).

34. Personeli të cilit i është besuar prodhimi, porositja, mbledhja, shqyrtimi, përpunimi apo vërtetimi i përmbajtjes do të shërbejë si një tregues i besueshëm i kontrollit redaktorial apo mbikëqyrjes. Ekzistenca e bordeve redaktoriale, kontrollorët apo mbikëqyrësit e caktuar me fuqitë redaktoriale, ose marrëveshjet për t'iu përgjigjur ose trajtuar kërkesat ose ankesat e përdoruesve përsa i përket përmbajtjes, do të jenë veçanërisht të dobishme në këtë drejtim.

35. Përsëri, duhet theksuar se nivele të ndryshme të kontrollit redaktorial lidhen me nivele të ndryshme të përgjegjësisë redaktoriale. Nivele të ndryshme të kontrollit redaktorial apo modaliteteve redaktoriale (për shembull *ex ante* sipas krahasimit me moderim *ex post*) kërkojnë përgjigje të diferencuara dhe pothuajse me siguri lejojnë shkallëzimi më të mirë të përgjigjes.

36. Si pasojë, një ofrues i një shërbimi ndërmjetës ose ndihmës, i cili kontribuon në funksionimin ose qasjen e mediave, por vetë nuk ushtron - ose nuk duhet të ushtrojë - kontroll redaktorial, dhe për këtë arsye ka përgjegjësi redaktoriale të kufizuar ose nuk ka asnjë përgjegjësi, nuk duhet të konsiderohet si media. Megjithatë, veprimi i tyre mund të jetë i rëndësishëm në kontekstin e mediave. Sidoqoftë, veprimi i ndërmarrë nga ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit ose ndihmëse, si rezultat i detyrimeve ligjore (për shembull heqja e përmbajtjes në përgjigje të një vendimi gjyqësor) nuk duhet të konsiderohet si kontroll redaktorial në kuptimin e mësipërm.

37. Mediat kanë ndërtuar besimin me kalimin e kohës përmes kompetencës dhe profesionalizmit të personelit të tyre, në veçanti të gazetarëve. Kolektivisht, ata kanë shprehur përkushtimin e tyre për të ruajtur vlerat e tyre në një gamë të gjerë të deklaratave, dokumenteve dhe kodeve që ata kërkojnë të promovojnë në të gjithë sektorin dhe të transmetojnë tek kolegët e tyre, në veçanti tek të sapoardhurit në profesion. Media të veçanta e kanë përforcuar këtë nëpërmjet kodeve të tyre të brendshme të praktikës, rregulloreve të personelit ose udhëzimeve dhe normave për procedurën dhe stilin. Edhe vetë-rregullimi flet për rëndësinë e medias dhe gazetarisë për shoqëritë tona, veçanërisht për demokracinë.

38. Sido që të shprehet, aderimi në etikën e profesionit, deontologjinë dhe standarde është një tregues i fortë i medias; standardet e përmendura shpesh në këtë kontekst janë sinqeriteti, përgjegjësia, liria e shprehjes dhe e medias, barazia, drejtësisë, dhe pavarësia gazetareske. Në mediat e reja, evidentimi i këtij kriteri mund të jetë më pak i dukshëm, por mund të gjendet në deklaratat e misionit, në rregulloret e personelit ose në afatet dhe kushtet e përdorimit. Edhe përzgjedhja e personelit, detyrat e besuara atyre, udhëzimet për punën e tyre, apo historiku ose kompetenca e tyre profesionale, mund të jenë të rëndësishme.

39. Etika e mediave (dhe gazetarëve), deontologjia dhe standardet janë baza e sistemeve të llogaridhënies së medias. Ka një gamë të gjerë të sistemeve të llogaridhënies së medias; ato përfshijnë mediat apo këshillat e shtypit, avokatët e popullit (duke përfshirë avokatët e brendshëm të përdoruesve), vlerësim joformal nga kolegët (media), dhe një sërë procesesh formale dhe joformale që lejojnë që mediat të japin llogari për performancën e tyre apo kryerjen e auditimeve etike.

40. Sistemet e llogaridhënies së medias ofrohen për procedurat e ankesave dhe për ekzistencën e organeve të ngarkuara me shqyrtimin e ankesave dhe vendim-marrjen në përputhje me standardet profesionale. Në lidhje me këtë, i duhet kushtuar vëmendje disponueshmërisë së mjeteve korrigjuese tipike për mediat (për shembull, përgjigje, korrigjim, ndjesë) ose mjeteve të tjera që sigurojnë kënaqësi në përgjigje të ankesave në lidhje me përmbajtjen e përhapur.

41. Sa i përket në veçanti mediave të reja, kodet e



sjelljes apo të standardeve etike për bloggerët janë pranuar tashmë nga të paktën një pjesë e komunitetit të gazetarisë në rrjet. Megjithatë, bloggerët duhet të konsiderohen si media vetëm nëse plotësojnë kriteret në një shkallë të mjaftueshme. Në mungesë të vetë-rregullimit, vendimet kombëtare dhe ndërkombëtare ose jurisprudenca (për shembull të gjykatësve kombëtare ose autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave dhe organeve ndërkombëtare, përfshirë Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut) kontribuojnë në formësimin e standardeve (për shembull sa i përket privatësisë apo mbrojtjes së të dhënave personale, apo mbrojtjes së fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme).

42. Kërkesat për të përfituar nga mbrojtja apo privilegjet e ofruara për mediat mund të jenë shumë domethënëse. Prerogativat, të drejtat dhe privilegjet të cilat mund të pohohen nga mediat ose nga gazetarët, subjekt i dispozitave përkatëse ligjore, përfshijnë: mbrojtjen e burimeve; komunikimet e privileguara dhe mbrojtjen kundër konfiskimit të materialit gazetaresk; lirinë e lëvizjes dhe qasjes në informacion; të drejtën e akreditimit; mbrojtjen nga ligjet e keqpërdorimit të shpifjes dhe fyerjes (për shembull mbrojtje në lidhje me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit, interesin publik në mirëbesim).



43. Për të arritur qëllimet e përshkruara më lart, mediat kërkojnë të shtrihen tek një numër i madh i njerëzve. Tradicionalisht, mediat ose komunikimi masiv janë përkufizuar si komunikim publik i ndërmjetësuar që i drejtohet një publiku të gjerë dhe është i hapur për të gjithë. Për këtë arsye, shtrirja ose shpërndarja faktike (numri i kopjeve, shikuesit apo përdoruesit) është një tregues i rëndësishëm në identifikimin e mediave dhe në dallimin e tyre nga komunikimi privat, duke përf-

shirë komunikimin privat që zhvillohet në një hapësirë publike (e cila në vetvete nuk është media, por mund të jetë inkorporuar në media apo në komunikim masiv në total). Megjithatë, nuk ka asnjë kuptim të vetëm ose të përbashkët të asaj që është masa apo publiku i gjerë; ai mund të ndryshojë nga një publik territorial, me interesa të njëjta apo bashkësi tjetër (për shembull grupet e synuara të mediave lokale, profesionale ose të komunitetit), tek publiku potencialisht global (në rastin e televizionit satelitor apo shërbimeve të caktuara të internetit).

44. Teknologjitë që bëjnë të mundur shpërndarjen jo-lineare ose sipas kërkesës të përmbajtjes, qasjen e kushtëzuar, shthurjen e përmbajtjes së dorëzuar elektronikisht, personalizimin e përmbajtjes apo unicastit, i kanë sjellë një dimension të ndryshëm përkufizimit dhe kanë sjellë një dimension të ri të komunikimit masiv. Edhe Interneti ka kapacitetin për të mbështetur gamën e plotë të komunikimit publik (një-me-shumë, shumë-me-shumë), si dhe të komunikimit në grup (disa-me-disa) dhe komunikimit privat (një-me-një); fakti se komunikimi i tillë ndodh në internet (një hapësirë publike) nuk nënkupton domosdoshmërisht se interneti është media.

45. Për të vlerësuar shtrirjen, i duhet kushtuar vëmendje publikut të mbledhur, domethënë të gjithë ata që përdorin platformën apo tipare të përbashkëta të shërbimit, dhe që mund të arrihet nga përmbajtja e prodhuar, e rregulluar, e zgjedhur, mbledhur ose shpërndarë nga operatori, përfshirë edhe rastet kur shpërndarja apo qasja në përmbajtje nuk është e njëkohshme. Mund të jetë e dobishme të shqyrtohet veçmas çështja e përmbajtjes së kërkuar nga ana e përdoruesit dhe që direkt ose indirekt lidhet me veprimtarinë e gjenerimit të të ardhurave të operatorit të shërbimit. Prandaj, numri i përdoruesve të regjistruar është i rëndësishëm.

46. Sa më lart është në përputhje me zhvillimin e jurisprudencës, e cila sugjeron se ekziston një kufi i hollë mes komunikimit publik dhe privat; si rezultat, botimi i përmbajtjes në rrjetet sociale ka sjellë pasoja për komunikim publik. Megjithatë, kjo nuk do të sjellë kategorizimin e përdoruesve si media (që do t'u kishte dhënë atyre qasje në media apo prerogativat ose privilegjet e gazetarëve). Për të përmbushur këtë kriter, një ofrues përmbajtjeje duhet të ndërmarrë hapa konkrete që ta rrisë përmbajtjen e projektit në një dimension të komunikimit masiv; kjo shtrirje mund të evidentohet nga përdorimi i brezit frekuencor të mjaftueshëm apo zhvillimi i platformave të

përshtatshme të shpërndarjes. I duhet kushtuar kujdes mundësisë së zhvillimeve të shpejta në këtë drejtim.

47. Ekosistemi i ri i rrjedhshëm u lejon mediave të veprojnë lehtë brenda mediave të tjera ose që operatorë të ndryshëm të mbivendosen, nganjëherë duke fshirë kufijtë midis tyre. Prandaj është e rëndësishme të bëhet dallimi mes roleve të tyre përkatëse, në mënyrë që të dallohen përgjegjësitë e tyre përkatëse. Ky proces mund të lehtësohet duke eksploruar shkallën në të cilën i ftuari, veç e veç, i plotëson kriteret e mediave. Kjo është gjithashtu e rëndësishme në mënyrë që të mos zgjerohet më shumë seç duhet nocioni i mediave për të përfshirë padrejtësisht përdoruesit të cilët prodhojnë ose kontribuojnë në krijimin e përmbajtjes.

48. Së bashku me kriteret e tjera, dimensionimi i hapësirave të mbyllura tërësisht, kolektive, në rrjet dhe të përbashkëta, të hartuara për të lehtësuar komunikimin interaktiv, duhet të lejojë të përcaktohet nëse ato janë media. Megjithatë, fakti i thjeshtë i qasjes së kufizuar nuk duhet automatikisht t'i skualifikojë (kjo është e krahasueshme me shërbimet mediatike në dispozicion vetëm me abonim).

49. Niveli i informimit dhe shpërndarjes është një kriter i rëndësishëm që, në mënyrë të qartë, ka ndikim në përfaqësimin e diferencuar dhe të shkallëzuar. Nëse shtrirja dhe shpërndarja janë të ulëta, shërbimi nuk duhet të konsiderohet si media. Megjithatë, kjo duhet të konsiderohet duke pasur parasysh madhësinë e tregut ose publikut potencial ose përdoruesve bazë dhe gjithashtu ndikimin potencial. Mungesa e shtrirjes dhe përhapjes mjaftueshëm të madhe nuk e përjashton vlerësimin si media, por, në të gjitha këto rastet, këto rrethana do të kenë një influencë në diferencim dhe shkallëzim.



50. Pritshmëritë e njerëzve ndjekin kryesisht kriteret e mësipërme (dhe treguesit e lidhur). Ata presin që media të jetë në dispozicion dhe të jetë aty për ta kur të dëshirojnë ta kthejnë vëmendjen e tyre mbi të. Pa paragjykuar ndërprerjen ose pezullimin e përkohshëm, shërbimet mediatike supozohen të vazhdueshme dhe gjerësisht të arritshme (kjo nuk përjashton shërbime për shqyrtim, me abonim ose subjekt i mënyrës së anëtarësimit).

51. Në përgjithësi, njerëzit i njohin mediat dhe mbështeten në një masë të madhe në media për informacion dhe përmbajtje të tjera. Ata presin që përmbajtja do të prodhohet sipas standardeve përkatëse profesionale. Në një shoqëri demokratike, ata llogarisin në disponueshmërinë e një vargu burimesh të informacionit dhe presin që përmbajtja e tyre të jetë e ndryshme, duke iu përgjigjur interesave të segmenteve të ndryshme në shoqëri.

52. Varësisht nga qëllimi dhe natyra e mediave specifike, pritshmëritë e publikut mund të ndryshojnë. Pritshmëritë në lidhje me mediat e shërbimit publik janë më të larta se në lidhje me disa media të tjera. Mediat e lajmeve natyrisht priten që të jenë të përditësuara rregullisht dhe të shpërndahen periodikisht. Njerëzit madje kanë pritshmëri në lidhje me përmbajtjen e natyrës komerciale, të cilat janë më të larta në lidhje me mediat apo përmbajtjet e mediave të projektuara për të miturit.

53. Në mënyrë që të jenë në gjendje të përmbushin rolin e tyre dhe të arrijnë qëllimin e tyre, mediat duhet të ftojnë besimin e publikut. Në varësi të qëllimit të shprehur apo të perceptuar, politikave redaktoriale, modelit të financimit dhe ndikimit, ndryshon edhe besimi që publiku u akordon mediave. Zhvillimi i standardeve profesionale dhe etike në një masë të madhe pasqyron pritshmërinë e njerëzve. Megjithatë, vetë-rregullimi mund të mos shihet gjithmonë si i mjaftueshëm dhe njerëzit presin nga autoritetet publike që të sigurohen që standardet minimale janë të garantuara. Ka edhe pritshmëri për transparencën dhe llogaridhënien. Nivelet më të larta të pritshme të besueshmërisë, standardeve, transparencës dhe llogaridhënies nuk sjellin domosdoshmërisht një shtrirje, shpërndarje apo ndikim më të lartë.

54. Pritjet e publikut në një shoqëri të caktuar

mund të zbulohen, në një farë mase, me anë të interesit dhe vëmendjes së ligjvënësve mbi këtë subjekt, dhe me rregullore ekzistuese (duke përfshirë bashkë-rregullim) Në një shoqëri globale ku mediat nuk njohin kufij, ka një pritshmëri të një shkalle të harmonizimit edhe në të kuptuarit e asaj që është media. Pra, zgjidhjet krahasuese mund të jenë të rëndësishme.

55. Shkalla dhe natyra e pritshmërive të publikut mund të ndryshojë shpejt si përsa i përket vetë mediave ashtu dhe pjesës që duhet luajtur nga krijuesit e politikave, në varësi të faktit nëse janë përmbushur kriteret dhe treguesit e tjerë dhe masës në të cilën janë përmbushur.

PJESA II - STANDARDET E APLIKUAR PËR MEDIAT NË EKOSISTEMIN E RI

KOMENTE PARAPRAKE

56. Qëllimi i kësaj pjese është që të ofrojë udhëzime për krijuesit e politikave si të zbatojnë standardet e mediave mbi aktivitetet e mediave të reja, shërbimet ose aktorët në mënyrë të shkallëzuar dhe të diferencuar. Më tej, ajo siguron një bazë efektive për implementimin e rekomandimeve që shtetet anëtare të angazhohen në dialog me të gjithë aktorët në ekosistemin e mediave, në mënyrë që të jenë të informuar siç duhet për kuadrin ligjor në fuqi. Ajo duhet gjithashtu t'u ndihmojë aktorëve mediatikë në çdo aktivitet vetë-rregullues në të cilin mund të angazhohen.

57. Teksa Rekomandimi mbi një nocion të ri të mediave dhe Pjesa I e kësaj shtojce pritet ta kalojnë testin e kohës për shkak të natyrës së tyre të gjerë, kjo pjesë, e cila është e një natyre më shumë pragmatike, mund të duhet të zhvillohet më tej, të përshtatet ose rishikohet periodikisht nën dritën e ndryshimeve në ekosistemin e medias.

58. Media dhe gazetarët janë subjekt i dispozitave të përgjithshme ligjore (domethënë ato që nuk janë specifike për mediat, qoftë civile, tregtare, të korporatave, tatimit apo ligjit penal). Megjithatë, duke pasur parasysh nevojat dhe rolin e mediave në shoqëri, mund të kenë nevojë që dispozita të caktuara të përgjithshme të interpretohen në mënyrë specifike për mediat (për shembull në lidhje me shpifjen, mbikëqyrjen, ndalimin dhe kontrollin, sekretet shtetërore ose konfidencialitetin e korporatave) ose aplikimi i tyre të shqyrtohet për të shmangur keqpërdorim e tyre që cenon lirinë e medias.

59. Në varësi të parimit se rregullimi i mediave, si një formë e ndërhyrjes, duhet të përputhet me kërkesat e domosdoshmërisë së rreptë dhe ndërhyrjes minimale, kornizat specifike rregullatore duhet t'i përgjigjen nevojës për t'i mbrojtur mediat nga ndërhyrja (njohja e prerogativave, të drejtave dhe privilegjeve përtej ligjit të përgjithshëm, ose duke siguruar një kuadër për ushtrimin e tyre), për të menaxhuar burimet e pakta (për të siguruar pluralizmin e mediave dhe diversitetin e përmbajtjes - neni 10, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut), ose për

të adresuar përgjegjësitë e mediave (në kuadër të kufijve të rreptë të përcaktuara në nenin 10, paragrafi 2, të Konventës dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut). Këto konsiderata kanë frymëzuar strukturën e kësaj pjese të shtojcës.

60. Në çdo rast, jepet një tregues i standardeve ekzistuese të Këshillit të Evropës, dhe shpjegohet shkurtimisht aplikimi i tyre në një mjedis të ri të mediave. Nuk ka asnjë përpjekje për të vendosur standarde në mënyrë shteruese. Standardet e zgjedhura duhet të shihen si shembuj të cilët mund të japin frymëzim për aplikimin e standardeve të tjera përkatëse të Këshillit të Evropës. Duke pasur parasysh natyrën dhe qëllimin e këtij instrumenti, udhëzimi është paraqitur në terma shumë të gjera; udhëzimi më i saktë do të duhet të konkludohet nga instrumente të ngjashme të vendosjes së standardeve të Komitetit të Ministrave (një listë e propozuar është paraqitur në fund të seksionit). Aplikimi i standardeve do të evoluojë dhe do të jetë në varësi të zhvillimeve në lidhje me aktorët e medias, shërbimet dhe aktivitetet.

A. Të drejtat, privilegjet dhe prerogativat



61. Nuk ka demokraci të vërtetë pa media të pavarur. Liria e medias duhet të kuptohet në terma të gjerë. Ajo përfshin lirinë e shprehjes dhe të drejtën për të shpërndarë përmbajtjen. Siç përcaktohet në nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kjo e drejtë duhet të jetë e garantuar pa marrë parasysh kufijtë. Aktorët duhet të jenë në gjendje të fillojnë aktivitetet e mediave apo të zhvillohen pa vështirësi

të tepruar nga komunikimi privat ose gjysmë-privat në një hapësirë publike në komunikimin masiv. Në veçanti, nuk duhet të ketë procese autorizimi paraprak; nëse kërkohet, shpallja e aktiviteteve të mediave duhet të ndjekë objektivin e rritjes së mbrojtjes së tyre nga ndërhyrjet, pa krijuar pengesa të pajustificuara për funksionimin e tyre.

62. Ka shumë shembuj të ndërhyrjes ose përpjekjeve për të ndërhyrë në pavarësinë e mediave në ekosistemin e ri. Ka pasur raporte të presionit të drejtpërdrejtë nga ana e politikanëve mbi mediat që ta ndërpresin ose ta tërheqin përmbajtjen dhe gjithashtu u janë bërë thirrje ndërmjetësve që të përjashtojnë aktorët e mediave nga shërbimet e tyre hosting. Respektimi i pavarësisë redaktoriale kërkon mungesën e censurës ose kontrollit *ex ante* të përmbajtjes. Media duhet të jetë e lirë nga bllokimi dhe masat e filtrimit. Bërja publike e të gjitha incidenteve të tilla duhet të jetë e mirëpritur.

63. Duhet theksuar rëndësia e rolit të ndërmjetësve. Ata ofrojnë mjete alternative dhe plotësuese apo kanale për shpërndarjen e përmbajtjes së mediave, duke zgjeruar shtrirjen dhe rritur efektivitetin e mediave që të arrijnë qëllimet dhe objektivat e tyre. Në një treg konkurrues të ndërmjetësve dhe ndihmësve, ata mund ta reduktojnë ndjeshëm rrezikun e ndërhyrjeve nga autoritetet. Megjithatë, duke pasur parasysh shkallën në të cilën media në ekosistemin e ri duhet të mbështetet në to, ka edhe një rrezik të censurës së vendosur përmes ndërmjetësve dhe ndihmësve. Situata të caktuara mund të përbëjnë rrezik të censurës private (nga ndërmjetësit dhe ndihmësit në lidhje me mediat për të cilat ata ofrojnë shërbime apo me përmbajtjen që ato mbajnë).

64. Ka shqetësim në rritje në lidhje me sulmet e mohimit të shërbimit ndaj mediave në mjedisin digital. Operatorë më të vegjël të medias, të cilat janë një komponent kyç i një peizazh pluralist dhe me diversitet të mediave, janë më të rrezikuara. Si rezultat, atyre mund edhe t'u refuzohen shërbimet hosting. Ka patur ankesa për veprim të tërthortë kundër mediave, duke penguar përgatitjet e tyre të financimit; procedurat tatimore ose konkurrenca mund të keqpërdoren në mënyrë të ngjashme.

65. Në ekosistemin e ri, të gjitha mediat duhet

të ruhen nga presioni, duke përfshirë edhe atë që është i motivuar politikisht ose që rrjedh nga interesat ekonomike. Media duhet të jetë e lirë nga censura dhe të ruhet nga vetë-censura. Pavarësia redaktoriale kërkon ndarjen efektive dhe të sigurt mes pronësisë ose kontrollit mbi mediat dhe marrjes së vendimeve përsa i përket përmbajtjes. Ky është një faktor i rëndësishëm në procesin e pjekurisë së mediave. Personat që ushtrojnë autoritet apo ndikimi politik duhet të përmbahen nga pjesëmarrja në vendimet redaktoriale të mediave. Kjo është veçanërisht e rëndësishme përsa i përket mediave në ekosistemin e ri që bartin material të aftë për formësimin e opinionit apo informimin e vendimeve politike të elektoratit. Këto konsiderata vlejnë njëloj për krijuesit dhe shpërndarësit e përmbajtjes.

66. Ligjet e shpifjes dhe fyerjes mund të keqpërdoren për të ndërhyrë në media, qoftë edhe me anë të masës ndëshkimore. Ato mund të kenë një efekt të fortë ftohës. Sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, shprehjet (ose përmbajtja) të cilat shqetësojnë, tronditin apo ofendojnë duhet të tolerohen. Në varësi të respektimit apo pastrimit të të drejtave përkatëse të pronësisë intelektuale, media duhet të jetë në gjendje të mbështetet në raporte të mëparshme të mediave apo material të publikuar, pa rrezik. Megjithatë, në ekosistemin e ri, duhet të konsiderohet ndikimi i akumuluar ose i shumëfishuar dhe nevoja e mundshme për ta shpërndarë përgjegjësinë në rast të dëmtimit (për shembull, dëmtimi që rezulton nga shpërndarja nga një botim i parë në krahasim me ndikimin e zgjeruar ose shumëzuar kur e njëjta përmbajtja shpërndahet nga tjetri, duke përfshirë mediat kryesore).

67. Të gjitha mediat në ekosistemin e ri duhet të kenë të drejtë të përdorin mbrojtjet e vërtetësisë dhe saktësisë së informacionit, mirëbesimin apo interesin publik (në veçanti në kontekstin e shqyrtimit të sjelljes së figurave publike apo politike dhe zyrtarëve publikë, dhe gjithashtu në lidhje me çështje të mbuluara nga sekretet shtetërore apo nga rregullat e konfidencialitetit të korporatave). Media duhet të jetë e sigurt që gjatë vlerësimit të përmbajtjes, fakti do të trajtohet ndryshe nga opinioni (ky i fundit lejon liri më të madhe). Media duhet gjithashtu të jetë në gjendje të mbështetet në lirinë e satirës dhe të drejtën për ekzagjerim.

68. Çdo veprim i kërkuar kundër mediave në lidhje me përmbajtjen duhet të respektojë në mënyrë rigoroze ligjet e zbatueshme; mbi të gjitha të drejtat ndërkombëtare të njeriut, në veçanti dispozitat e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe të jetë në përputhje me masat mbrojtëse procedurale. Duhet të ketë një supozim në favor të lirisë së shprehjes dhe informacionit dhe në favor të lirisë së medias. Duhet të shqyrtohet roli i përdoruesve dhe i natyrës së përmbajtjes së gjeneruar nga përdoruesi.

69. Qoftë në formën e detyrimeve negative (për të mos ndërhyrë) apo detyrimeve pozitive (për të lehtësuar ushtrimin e lirisë së shprehjes dhe të drejtën për të dhënë dhe marrë informacion pa marrë parasysh kufijtë, duke përfshirë edhe sigurimin e disponueshmërisë së mjeteve juridike efektive në rast të ndërhyrjes nga aktorë të tjerë) shteti është bartësi i këtyre të drejtave, privilegjeve dhe prerogativave. Kjo duhet të shkallëzohet në varësi të rrethanave të çdo rasti dhe mundësive reale që shteti të marrë masat e nevojshme parandaluese apo përmirësuese. Përgjegjësia e shtetit nuk duhet, në asnjë rast, të interpretohet si e lejuar për çdo kontroll, inspektim apo ndërhyrje, apo ndonjë veprim tjetër i aftë për të penguar ushtrimin legjitim të së drejtës për lirinë e shprehjes dhe të drejtës për të dhënë dhe marrë informacion pa marrë parasysh kufijtë.



70. E drejta e medias për të hetuar është thelbësore për demokracinë; prandaj ajo duhet të njihet, ruhet dhe promovohet në ekosistem të ri të medias. E drejta e gazetarëve për të hetuar mund të lehtësohet nga akreditimi; ku është i aplikueshëm, profesionistëve të mediave në ekosistemin e ri duhet t'u ofrohet akreditimin pa diskriminim dhe pa vonesë apo pengesë të panevojshme. E drejta për lirinë e lëvizjes (p.sh. qasje në zonat e krizës) dhe qasjes në informacion janë shumë të rëndësishme për të gjithë profesionistët e medias. Kur është e përshtatshme, duhet t'u ofrohet mbrojtje, pa diskriminim.

71. Sa më lart mund të zgjerohet, në raste të caktuara, për të siguruar mbrojtje apo disa forma të mbështetjes (për shembull udhëzim ose trajnim në mënyrë që të mos vënë jetën e tyre në rrezik) për ata aktorë që, teksa i përmbushin disa kriteret dhe tregues të përcaktuar në Pjesën I të kësaj shtojce, nuk mund të kualifikohen plotësisht si media (për shembull blogerët individuale). Një përgjigje e shkallëzuar duhet të marrë parasysh shkallën në të cilën aktorët e tillë mund të konsiderohen pjesë e ekosistemit të mediave dhe kontribues në funksionet dhe rolin e mediave në një shoqëri demokratike.

72. Komponentët e tjerë thelbësorë të së drejtës për të hetuar janë privatësia e komunikimit dhe mbrojtja nga konfiskimi i materialit profesional. Çdo formë e mbikëqyrjes së profesionistëve të mediave, duke përfshirë edhe gjurmimin e lëvizjeve të tyre përmes mjeteve elektronike, duhet të konsiderohet me maturi të madhe dhe të bëhet objekt i masave mbrojtëse të përforcuara.

73. Mbrojtja e burimeve është gjithnjë subjekt i njohjes formale ligjore. Ka nevojë për mbrojtje të fuqishme të informuesve. Në ekosistem të ri të medias, mbrojtja e burimeve duhet të përfshijë identitetin e përdoruesve të cilët vënë në dispozicion përmbajtje me interes publik në hapësirat kolektive online të përbashkëta të cilat janë të dizajnuara për të lehtësuar komunikimin masiv interaktiv (ose komunikimin masiv në total); kjo përfshin platforma për ndarjen e përmbajtjes dhe shërbimet e rrjeteve sociale. Mund të jenë të nevojshme marrëveshje për të autorizuar përdorimin e pseudonimeve (për shembull në rrjetet sociale) në rastet kur zbulimi i identitetit mund të tërheqë hakmarrjen (për shembull si pasojë e aktivizmit politik apo të drejtave të njeriut).



74. Mediat duhet të kenë qasje të drejtë në rrjetet e komunikimit elektronik (duke përfshirë shërbimet

hosting) dhe duhet të jenë në gjendje të mbështeten në parimin e neutralitetit të Internetit. Standardet e ndërveprimit dhe të hapura mund të jenë mjete të dobishme për eliminimin e barrierave teknike në shpërndarjen e përmbajtjes së mediave. Duhet të konsiderohet ri-interpretimi i rregullave të "transmetimit të detyrueshëm" në ekosistem të ri të medias.

75. Për aq sa veprimi apo vendimet e tyre mund të kenë një ndikim mbi mediat në ekosistemin e ri, ndërmjetësi dhe ndihmësi duhet të jenë të lirë nga presioni apo ndikimi që ka për qëllim të ndikojë mbi mediat, pavarësinë e tyre apo vendimet redaktoriale. Masa të politikës mund të jenë të nevojshme për ta bërë efektive këtë kërkesë.

76. Në rast të veprimit të ligjshëm (për shembull që rezulton nga vendimet e kuptueshme të biznesit) nga një ndërmjetës, ndihmës apo tjetër aktor që ndikon në kushtet e domosdoshme për funksionimin e medias, mund të jenë të dëshirueshme marrëveshjet për të ruajtur funksionim e vazhduar të mediave (për shembull për të ruajtur pluralizmin dhe diversitetin në interesin publik). Kjo mund të kërkojë masa mbrojtëse shtesë (për shembull në kontekstin e proceseve gjyqësore) ose konsiderim nga autoritetet përkatëse të mjeteve të mundshme për të parandaluar ose zbutur rezultatin e padëshirueshëm. Kjo gjithashtu mund të jetë e rëndësishme, *mutatis mutandis*, në lidhje me veprime nga autoritetet (për shembull duke aplikuar ligjin e taksave) në qoftë se një veprim i tillë mund të ketë një ndikim negativ në liritë dhe pluralizmin e mediave dhe në masën e nevojshme në një shoqëri demokratike.

B. Pluralizmi i mediave dhe diversiteti i përmbajtjes



77. Siç është treguar tashmë, aktorët në ekosistemin e ri duhet të jenë në gjendje të fillojnë aktivitete të mediave apo të zhvillohen në aktivitetet mediatike pa vështirësi të panevojshme. Në veçanti, nuk duhet të ketë procese autorizimi paraprak. Në ekosistem të ri të mediave ka një bollëk të aktorëve, mjeteve dhe platformave për shpërndarjen dhe përmbajtjen; megjithatë, licencimi ende mund të justifikohet në raste të jashtëzakonshme nga nevoja për të menaxhuar burimet e pakta (për shembull spektrin elektromagnetik të gjatësisë së valëve).

78. I kufizuar në raste të tilla të jashtëzakonshme, licencimi apo autorizimi duhet të ndjekë interesin publik, pikërisht për të garantuar ekzistencën e një game të gjerë të mediave të pavarura dhe të ndryshme. Masat e licencimit dhe autorizimit duhet t'i përgjigjen nevojës, dhe këmbëngulja për nevojën e masave të tilla duhet të rishqyrtohet në dritën e zhvillimeve.

79. Pluralizmi nuk do të garantohet automatikisht nga ekzistenca e një numri të madh të mjeteve të komunikimit masiv të arritshme për njerëzit. Për më tepër, në një situatë të përqendrimit të fuqishëm mediatik, aftësia për të formësuar apo ndikuar opinionin publik apo zgjedhjet e njerëzve mund t'i takojë një ose vetëm disa aktorëve. Keqpërdorimi i kësaj fuqie mund të ketë pasoja të dëmshme për pluralizmin politik dhe për proceset demokratike. Në ekosistemin e ri mediatik, disa aktorë kanë zhvilluar shërbime ose aplikacione të cilat i kanë vënë në një pozitë dominuese në nivel kombëtar apo edhe në nivel global. Edhe në qoftë se nuk ka dëshmi të keqpërdorimit, një pozicion i tillë dominant mund të përbëjë një rrezik potencial.

80. Monitorimi i trendeve dhe përqendrimit në ekosistemin e mediave do t'u lejojë autoriteteve kompetente të qëndrojnë krah për krah zhvillimeve dhe t'i vlerësojnë rreziqet. Masat rregullatore mund të jenë të nevojshme me qëllim të garantimit të transparencës së plotë të pronësisë së mediave. Kjo do të ndihmojë në identifikimin e masave parandaluese ose korrigjuese, nëse është e përshtatshme dhe duke pasur parasysh karakteristikat e secilit treg të mediave, me qëllim të parandalimit të niveleve të përqendrimit të mediave që do të mund të krijojnë rreziqe për demokracinë apo për rolin e mediave në proceset demokratike.

81. Shërbimi i mediave publike është thelbësor në modelin evropian, që përfshin bashkëjetesën e shërbimit publik, komercial dhe mediave të komunitetit. Ato duhet t'u përmbahen standardeve të larta profesionale dhe duhet, në mënyrë ideale, të përfshijnë publikun në strukturat e veta qeverisëse. Objektivi i tyre duhet të jetë sigurimi i ofertës universale, cilësisë, përmbajtjes së besueshëm dhe të larmishme, dhe pluralizmit politik në media. Mediat e shërbimit publik të pajisura dhe të financuara në mënyrë të përshtatshme, duke gëzuar pavarësi të mirëfilltë redaktoriale dhe autonomi institucionale, duhet të kontribuojnë në kundërbalancimin e rrezikut të keqpërdorimit të pushtetit të mediave në një situatë të përqendrimit të fuqishëm të medias.

82. Prandaj mediat e shërbimit publik duhet të kenë një vend të veçantë në ekosistemin e ri të medias, dhe duhet të jenë të pajisura për të siguruar cilësi të lartë dhe përmbajtje të reja dhe shërbime në mjedisin digjital, dhe duhet të jenë në gjendje të përdorin mjetet përkatëse (për shembull për të lehtësuar ndërveprimin dhe angazhimin).

83. Ekosistemi i ri ofron një mundësi të paparë për të inkorporuar diversitetin në qeverisjen e mediave, në veçanti sa i përket pjesëmarrjes së balancuar gjinore në proceset e prodhimit, ato redaktoriale dhe të shpërndarjes. E njëjta gjë është e vërtetë në lidhje me grupe të ndryshme etnike dhe fetare. Ky do të jetë një faktor kyç në sigurimin e përfaqësimit të balancuar dhe mbulimit nga media dhe në luftimin e stereotipeve në lidhje me të gjitha grupet përbërëse të shoqërisë.

C. Përgjegjësitë e Mediave



84. Funkcioni mbikëqyrës, përkatësisht shqyrtimi i çështjeve publike dhe politike dhe çështjeve private apo të biznesit të lidhura me interesin publik, kontribuon për të justifikuar lirinë e gjerë të mediave; megjithatë, është i mbuluar nga një kërkesë për zell më të madh në drejtim të informacionit faktik. Shqyrtimi duhet të përfshijë raportim të saktë, në thellësi dhe kritik. Ky dallon nga praktikat gazetareske të cilat padrejtësisht përfshijnë sondazhe që ekspozojnë jetën private dhe familjare të njerëzve në një mënyrë që do të ishte në kundërshtim me të drejtat e tyre themelore. Mediat duhet të ushtrojnë kujdes të veçantë që të mos kontribuojnë në stereotipet rreth anëtarëve të grupeve të caktuara etnike ose fetare dhe për stereotipet seksiste. Përfaqësuesive të të gjitha grupeve u duhet ofruar mundësia për të kontribuar në përmbajtje, të shprehin pikëpamjet e tyre dhe të shpjegojnë kuptimin e tyre të fakteve; mediat duhet të konsiderojë miratimin e një qasjeje proaktive në këtë drejtim.

85. Në varësi të saktësisë së informacionit, e drejta për respektimin e nderit dhe reputacionit gjen kufijtë e saj në interes të publikut. Profesionalizmi kërkon verifikimin e informacioneve dhe vlerësimin e besueshmërisë, por nuk kërkon që të informohet një person për qëllimin e shpërndarjes së informacionit në lidhje me të para se të përhapet. Kërkesa e saktësisë është më pak me vend ndaj opinionit, komenteve dhe argëtimit, të cilat gjithashtu lejojnë ekzagjerim. Megjithatë, mediat duhet t'i dallojnë këto forma të shprehjes nga informacioni faktik.

86. Kërkesat e mësipërme duhet të shkallëzohen

duke pasur parasysh politikat dhe proceset redaktoriale të miratuara nga media në fjalë dhe shtrirjen e ndikimit të tyre të mundshëm, si dhe pritjet e publikut në lidhje të to. Krijuesit e përmbajtjes mediatike, redaktorët dhe shpërndarësit duhet t'u përmbahen standardeve përkatëse profesionale, përfshirë ato të dizajnuara për të luftuar diskriminimin dhe stereotipet dhe për të promovuar barazinë gjinore. Ata duhet të ushtrojnë kujdes të veçantë për të siguruar mbulimin etik të çështjeve të minoriteteve dhe të grave, edhe duke shoqëruar pakicat dhe gratë në proceset e krijimit, ato redaktoriale dhe të shpërndarjes.

87. Roli i mediave, qofshin tradicionale apo jo, në informimin e publikut në lidhje me proceset penale është i rëndësishëm në një shoqëri demokratike. Në ushtrimin e përgjegjësinë së tyre redaktoriale, mediat duhet të jenë të vëmendshme që të mos shqetësojnë rrjedhën e drejtësisë apo të rrezikojnë funksionimin korrekt të gjyqësorit, jetën private dhe sigurinë e të gjithë atyre të përfshirë dhe, në veçanti, supozimin e pafajësisë së të dyshuarit ose të akuzuarit. Duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë ruajtjes së dinjitetit të personave të cënueshëm, viktimave, dëshmitarëve dhe të afërmeve të personave të prekur nga proceset penale. Kjo nuk duhet të pengojë dhënien e informacionit në interes të publikut.

88. Ka një sasi të madhe të informacionit personal dhe të dhënave në ekosistemin e ri të medias, duke përfshirë edhe në hapësirat e përbashkëta në internet të dizajnuara për të lehtësuar komunikimin interaktiv në masë (ose komunikimin masiv në total). Menaxhimi, grumbullimi dhe përdorimi i informatave dhe të dhënave të tilla duhet të respektojë të drejtën e njerëzve për jetë private dhe familjare siç mbrohet me nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke pasur parasysh edhe dispozitat e Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale (ETS nr 108). Qëndrueshmëria e përmbajtjes në mjedise digjitale dhe potenciali i saj për shpërndarje dhe ri-përdorim kërkon kujdes të veçantë dhe, në rast nevojë, një veprim të shpejtë me qëllim të zbutjes së dëmeve. Mediat që veprojnë në ekosistemin e ri duhet të vendosin lart në agjendën e tyre respektimin e të drejtave të njeriut dhe standardeve që kanë të bëjnë me profilizimin.

të përmbajtjes ri-përdoren ose ri-transmetohen. Në lidhje me këtë, mediat duhet të respektojnë të drejtat e pronës intelektuale të të tjerëve. Pa paragjykuar shimin privat dhe kolektiv privat të përmbajtjes, duke përfshirë edhe në hapësirat e përbashkëta në internet, si dhe forma të tjera të përdorimit të autorizuar, vëmendje i duhet kushtuar modaliteteve të zbatimit dhe respektimit të këtyre të drejtave në kontekstin e përmbajtjes së gjeneruar ose postuar nga përdoruesi.

90. Sistemet e brendshme efektive të llogaridhënies së mediave të mbështetur nga standardet e duhura profesionale shpesh justifikojnë mungesën, ose zvogëlojnë nevojën për llogaridhënie të jashtme. Aktorët në ekosistemin e ri duhet të zhvillojnë mekanizma të përshtatshme të ankesave dhe të përpiqen për të ofruar mjetet juridike ndaj palëve të treta që konsiderojnë se kanë pësuar dëme për shkak të aktiviteteve apo shërbimeve të mediave (për shembull e drejta për t'u përgjigjur, korrigjim, ndjesë).



91. Mediat duhet të përmbahen nga përcjellja e gjuhës së urrejtjes apo përmbajtje të tjera që nxisin dhunë ose diskriminim për çfarëdo arsye. Kërkohet vëmendje e veçantë nga ana e aktorëve që veprojnë në hapësira kolektive në rrjet të cilat janë të dizajnuara për të lehtësuar komunikimin interaktiv masiv (ose komunikimin masiv në total). Ata duhet të jenë të vëmendshëm në përdorimin e shprehjeve të motivuara nga paragjykime raciste, ksenofobe, anti-semite, misogjene, seksiste (duke përfshirë personat LGBT) ose paragjykime të tjera dhe në kundërpërgjigjet redaktoriale. Aktorëve në ekosistemin e ri të mediave mund t'u kërkohet (me ligj) t'i raportojnë tek autoritetet kompetente kërcënimet me dhunë të bazuara në arsye racore, etnike, fetare, gjinore ose arsye të tjera që vijnë në vëmendjen e tyre.

89. Në ekosistemin e ri, sasi të konsiderueshme

92. Nga ana tjetër, mediat mund të sigurojnë

një imazh të balancuar (ose pozitiv) të grupeve të ndryshme që përbëjnë shoqërinë dhe kontribuojnë për një kulturë të tolerancës dhe të dialogut. Përveç rasteve të përcaktuara me ligj duke respektuar dispozitat e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, asnjë grup në shoqëri nuk duhet të diskriminohet në ushtrimin e së drejtës së shoqatës e cila, në ekosistem të ri të mediave, përfshin shoqatën në rrjet.

93. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet ruajtjes së dinjitetit, sigurisë dhe privatësisë së fëmijëve. Përmbajtja në lidhje me ta mund të jetë një burim i paragjykitimeve aktuale dhe të ardhshme. Si pasojë, nuk duhet të ketë regjistrim të qëndrueshëm ose të përhershëm dhe të arritshëm të përmbajtjes që lidhet ose është krijuar nga fëmijët, e cila sfidon dinjitetin e tyre, sigurinë apo jetën private, ose përndryshe i bën ata të prekshëm tani ose në një fazë të mëvonshme të jetës së tyre.

94. Rreziku i dëmtimit mund të lindë nga një gamë e gjerë e përmbajtjes dhe sjelljes. Përmbajtja e destinuar vetëm për të rriturit duhet të identifikohet qartë për të lehtësuar bërjen e saj të paarrtshme për fëmijët. Mbrojtja e fëmijëve nuk duhet të ndikojë në lirinë e tyre të shprehjes dhe të drejtën për të kërkuar dhe marrë informacion. Mediat mund të kontribuojnë në zhvillimin e hapësirave të sigurta (kopshte të rrethuar me mure), si dhe mjeteve të tjera që lehtësojnë qasjen në faqet e internetit dhe përmbajtje të përshtatshme për fëmijët, për zhvillimin dhe përdorimin vullnetar të etiketave dhe markave të besimit, në zhvillimin e aftësive midis fëmijëve, prindërve dhe edukatorëve që ta kuptojnë më mirë dhe të merren me përmbajtjen dhe sjelljen që mbart rrezik për lëndim.

95. Ngacmimi, poshtërimi, frikësimi dhe përndjekja mund të lehtësohen në ekosistem të ri të mediave nga hapësirat kolektive në rrjet, gjurmimi i aplikacioneve apo edhe motorët e kërkimit dhe teknologjia e profilizimit. Gratë janë shpesh viktimat të këtyre formave të abuzimit, të cilat mund të çojnë në dhunë dhe abuzim fizik (duke përfshirë atë seksuale) të cilat janë shprehje të papranueshme të pabarazisë. Vëmendje i duhet kushtuar edhe përdorimit të mundshëm abuziv të teknologjisë në lidhje me anëtarët e minoriteteve.

96. Në rastet e lartpërmendura, përgjigjja do të

varet nga rrethanat, duke përfshirë natyrën dhe qëllimin e veprimtarisë ose shërbimit në fjalë, si dhe proceset e redaktoriale të vetë aktorit. Një përjasje e shkallëzuar duhet të marrë parasysh mundësitë e aktorëve në fjalë (për shembull ata që veprojnë në hapësira kolektive në internet ose ofrojnë motorë kërkimi, aplikacione dhe teknologji gjurmimi apo profilizimi) për të adresuar ose zbutur rreziqet në fjalë. Grupet përkatëse të interesit mund të inkurajohen për të eksploruar së bashku mundësinë e heqjes ose fshirjes së përmbajtjes në rastet e duhura, në atë masë që ajo nuk është në kundërshtim me të drejtën themelore të lirisë së shprehjes, duke përfshirë edhe gjurmët e saj (shkrimet, shënimet dhe përpunimin), brenda një periudhë të arsyeshme të shkurtër kohe. Aftësitë më të mëdha teknike sjellin me vete përgjegjësi më të mëdha. Vetë-rregullimi mund të plotësohet në mënyrë të dobishme me ngritjen e kapaciteteve (për shembull rritjen e kompetencave ndërkulturore) dhe duke ndarë praktikatat më të mira ose korrigjuese të zhvilluara brenda sektorëve të aktiviteteve në ekosistem të ri të mediave.



97. Liria e shprehjes vlen edhe për reklamat komerciale dhe politike, shitjet televizive dhe sponsorizimin. Kufizimet në këtë drejtim janë të pranueshme vetëm brenda kushteve të përcaktuara në nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kufizime të tilla mund të jenë të nevojshme për mbrojtjen e konsumatorëve, të miturve, shëndetit publik apo proceseve demokratike.

98. Në ekosistemin e ri të mediave, potenciali për reklama abuzive, ndërhyrëse ose të rreme është më i madh se kurrë më parë. Kjo bën thirrje për përgjegjësi të zgjeruara nga ana e aktorëve të mediave. Mund të kërkohej vetë-rregullim ose bashkë-rregullim dhe, në raste të caktuara, rregullore.

D. Instrumentet e referencës

KONVENTA DHE TRAKTATE TË KËSHILLIT TË EVROPËS NË FUSHËN E MEDIAVE

- Konventa për Informim dhe Bashkëpunimin Ligjor në lidhje me “Shërbimet e shoqërisë informatike” (ETS Nr 180, 2001)
- Konventa Evropiane për mbrojtjen ligjore të shërbimeve të bazuara, apo të përbërë nga, qasja e kushtëzuar (ETS Nr 178, 2000)
- Konventa Evropiane për Televizionin Ndërkufitar (ETS Nr 132, 1989) dhe Protokolli që amendon Konventën Evropiane për Televizionin Ndërkufitar (ETS Nr 171, 1998)
- Konventa Evropiane në lidhje me pyetjet mbi Ligjin e të drejtës së autorit dhe të drejtat fqinje në Kornizën e Transmetimit Ndërkufitar nga Sateliti (ETS Nr 153, 1994)
- Marrëveshja Evropiane në lidhje me Shkëmbimet e Programit me anë të Filmave Televizivë (ETS Nr 27, 1958)
- Marrëveshja Evropiane mbi Mbrojtjen e Emisioneve Televizive (ETS Nr 34, 1960)
- Marrëveshja Evropiane për Parandalimin e Emisioneve të transmetuara nga stacionet jashtë Territoreve Kombëtare (ETS Nr 53, 1965)

KONVENTA TË TJERA ME DISPOZITAT PËRKATËSE PËR MEDIA

- Konventa mbi Krimin Kibernetik (ETS Nr 185, 2001) dhe Protokolli shtesë i Konventës mbi krimin kibernetik, lidhur me penalizimin e akteve të natyrës raciste dhe ksenofobe të kryera përmes sistemeve kompjuterike (ETS Nr 189, 2003)
- Konventa për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale (ETS Nr 108, 1981) dhe Protokolli Shtesë i Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale, në lidhje me autoritetet mbikëqyrëse dhe rrjedhat e të dhënave ndërkufitare (ETS Nr 181, 2001)
- Marrëveshja Kornizë mbi Mbrojtjen e pakicave Kombëtare (ETS Nr 157, 1995)
- Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave (ETS Nr 148, 1992)

KOMITETI I MINISTRAVE

2010

- Rekomandimi CM/Rec(2010)13 mbi mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale në kontekstin e profilizimit
- Deklarata për menaxhimin e burimeve të adresave të protokollit të internetit në interes të publikut (29 shtator 2010)
- Deklarata mbi neutralitetin e rrjetit (29 shtator 2010)
- Deklarata për agjendën digjitale për Evropën (29 shtator 2010)
- Deklarata për pjesëmarrje të zgjeruar të shteteve anëtare në çështjet e qeverisjes së internetit - Komiteti Këshillimor Qeveritar (GAC) i Korporatës së Internetit për Caktimin e Emrave dhe Numrave (ICANN) (26 maj 2010)
- Deklarata mbi masat për të promovuar respektimin e nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (13 janar 2010)

2009

- Rekomandimi CM/Rec(2009)5 mbi masat për të mbrojtur fëmijët nga përmbajtje dhe sjellje të dëmshme dhe për të promovuar pjesëmarrjen e tyre aktive në mjedisin e ri të informacionit dhe komunikimit.
- Deklarata mbi rolin e medias së komunitetit në promovimin e kohezionit social dhe dialogut ndërkulturor (11 shkurt 2009)

2008

- Rekomandimi CM/Rec(2008)6 mbi masat për të promovuar respektin për lirinë e shprehjes dhe informimit në lidhje me filtrat e internetit
- Deklarata për pavarësinë dhe funksionet e autoriteteve rregullatore për sektorin e transmetimit (26 mars 2008)
- Deklarata mbi mbrojtjen e dinjitetit, sigurisë dhe privatësisë së fëmijëve në internet (20 shkurt 2008)
- Deklarata mbi alokimin dhe menaxhimin e dividendit digjital dhe interesit të publikut (20 shkurt 2008)

2007

- Rekomandimi CM/Rec(2007)16 mbi masat për të promovuar vlerën e shërbimit publik të internetit
- Rekomandimi CM/Rec(2007)15 mbi masat në lidhje me mbulimin mediatik të fushatave zgjedhore
- Rekomandimi Rec(2007)11 mbi promovimin e lirisë së shprehjes dhe informimit në mjedisin e ri të informacionit dhe komunikimit.
- Rekomandimi CM/Rec(2007)3 mbi kompetencat e mediave të shërbimit publik në shoqërinë e informacionit
- Rekomandimi CM/Rec(2007)2 për pluralizmin e mediave dhe diversitetin e përmbajtjes së mediave
- Udhëzimet mbi mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe informacionit në kohë krize (26 shtator 2007)
- Deklarata mbi mbrojtjen dhe promovimin e gazetarisë hulumtuese (26 shtator 2007)
- Deklarata mbi mbrojtjen e rolit të mediave në demokraci në kontekstin e përqendrimit të mediave (31 janar 2007)

2006

- Rekomandimi Rec(2006)12 për fuqizimin e fëmijëve në mjedisin e ri të informacionit dhe komunikimit.
- Rekomandimi Rec(2006)3 mbi Konventën e UNESCO për mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore
- Deklarata për garantimin e pavarësisë së transmetimit të shërbimit publik në vendet anëtare (27 shtator, 2006)

2005

- Deklarata mbi të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit në Shoqërinë e Informacionit, (13 maj 2005)
- Deklarata mbi lirinë e shprehjes dhe informimit në media në kontekstin e luftës kundër terrorizmit (2 mars 2005)

2004

- Rekomandimi Rec(2004)16 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi të drejtën për përgjigje në mjedisin e ri të mediave

- Deklarata për lirinë e debatit politik në media (12 shkurt 2004)

2003

- Rekomandimi Rec(2003)13 mbi dhënien e informacionit nëpërmjet mediave në lidhje me proceset penale
- Rekomandimi CM/Rec(2003)9 mbi masat për të promovuar kontributin demokratik dhe shoqëror të transmetimeve digjitale
- Rekomandimi Rec(2003)13 mbi dhënien e informacionit nëpërmjet mediave në lidhje me proceset penale (10 korrik 2003)
- Deklarata mbi Lirinë e Komunikimit në Internet, (28 maj 2003).
- Mesazhi politik në Samitin Botëror mbi Shoqërinë e Informacionit (WSIS) (19 qershor 2003)

2002

- Rekomandimi Rec(2002)7 mbi masat për të rritur mbrojtjen e të drejtave fqinjësore të organizatave të transmetimit
- Rekomandimi Rec(2002)2 për qasje në dokumente zyrtare

2001

- Rekomandimi Rec(2001)8 mbi vetë-rregullimin në lidhje me përmbajtjen kibernetike (vetë-rregullimi dhe mbrojtja e përdoruesit nga përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme në shërbimet e komunikimeve të reja dhe të informacionit)
- Rekomandimi Rec(2001)7 mbi masat për të mbrojtur të drejtën e autorit dhe të drejtat e fqinjësisë dhe për të luftuar piraterinë, sidomos në mjedisin digjital

2000

- Rekomandimi Rec(2000)23 mbi pavarësinë dhe funksionet e autoriteteve rregullatore për sektorin e transmetimit
- Rekomandimi Rec(2000)7 mbi të drejtën e gazetarëve për të mos zbuluar burimet e tyre të informacionit
- Deklarata mbi diversitetin kulturor (7 dhjetor 2000)

1999

- Rekomandimi CM/Rec(99)15 mbi masat në lidhje me mbulimin mediatik të fushatave zgjedhore
- Rekomandimi Rec(99)14 mbi shërbimin universal të komunitetit në lidhje me shërbime të reja të komunikimit dhe informacionit
- Rekomandimi Rec(99)5 për mbrojtjen e privatësisë në internet
- Rekomandimi Rec(99)1 për masat për promovimin e mediave pluraliste
- Deklarata për shfrytëzimin e prodhimeve të mbrojtura të radios dhe televizionit që mbahen në arkivat e organizatave të transmetimit (9 shtator 1999)
- Deklarata për një politikë evropiane për teknologjitë e reja të informacionit (7 maj 1999)

1997

- Rekomandimi Rec(97)21 mbi mediat dhe promovimin e një kulture tolerance
- Rekomandimi Rec(97)20 mbi "gjuhën e urrejtjes"

- Rekomandimi 1555 (97) mbi portretizimin e dhunës në media elektronike

1996

- Rekomandimi Rec(96)10 mbi garancine e pavarësisë së shërbimit të transmetimit publik
- Rekomandimi Rec(96)4 mbi mbrojtjen e gazetarëve në situata konflikti dhe tensioni
- Deklarata për mbrojtjen e gazetarëve në situata konflikti dhe tensioni (3 maj 1996)

1995

- Rekomandimi Rec(95)13 në lidhje me problemet e ligjit të procedurës penale lidhur me teknologjinë e informacionit
- Rekomandimi Rec(95)1 mbi masat kundër piraterisë audio dhe audio-vizuale

1994

- Rekomandimi Rec(94)13 për masat për promovimin e mediave transparente
- Rekomandimi Rec(94)3 mbi promovimin e edukimit dhe vetëdijesimit në fushën e të drejtave të autorit dhe të drejtat e fqinjësisë që kanë të bëjnë me krijimtarinë
- Deklarata mbi të drejtat e fqinjësisë (17 shkurt 1994)

1993

- Rekomandimi Rec(93)5 përmban parime që kanë për qëllim promovimin e shpërndarjes dhe transmetimit të veprave audio-vizuale me origjinë nga vende ose rajone me një prodhim të ulët audio-vizuale ose një mbulim të kufizuar gjeografik ose gjuhësor në tregjet televizive evropiane

1992

- Rezoluta Res(92)70 mbi ngritjen e një Observatori Audio-vizual Evropian
- Rekomandimi Rec(92)19 mbi video lojëra me përmbajtje raciste
- Rekomandimi Rec(92)15 në lidhje me mësimdhënien, kërkimin dhe trajnimin në fushën e ligjit dhe të teknologjisë së informacionit

1991

- Rekomandimi Rec(91)14 mbi mbrojtjen juridike të shërbimeve të koduara televizive
- Rekomandimi Rec(91)5 për të drejtën e raportimit të shkurtër mbi ngjarjet e mëdha ku të drejtat ekskluzive për transmetimin e tyre televiziv janë blerë në një kontekst ndërkufitar

1990

- Rekomandimi Rec(90)11 mbi parimet që lidhen me pyetjet e ligjit të së drejtës së autorit në fushën e reprografisë
- Rekomandimi Rec(90)10 mbi kinematë për fëmijë dhe adoleshentë

1989

- Rekomandimi Rec(89)7 lidhur me parimet mbi shpërndarjen e videogrameve që kanë përmbajtje të

dhunshme, brutale ose pornografike

1988

- Rezoluta Res(88)15 për ngritjen e një fondi mbështetës Evropian për bashkë-prodhimin dhe shpërndarjen e veprave krijuese kinematografike dhe audio-vizuale ("Eurimages")
- Rekomandimi Rec(88)2 mbi masat për të luftuar piraterinë në fushën e të drejtave të autorit dhe të drejtave fqinje
- Rekomandimi Rec(88)1 mbi kopjimet private audio dhe audio-vizive

1987

- Rekomandimi Rec(87)7 mbi shpërndarjen e filmit në Evropë

1986

- Rekomandimi Rec(86)14 mbi hartimin e strategjive për të luftuar pirjen e duhanit, alkoolit dhe varësinë nga droga në bashkëpunim me formues të opinionit dhe media
- Rekomandimi Rec(86)9 mbi të drejtën e autorit dhe politikën kulturore
- Rekomandimi Rec(86)3 mbi promovimin e prodhimeve audio-vizuale Evropë
- Rekomandimi Rec(86)2 mbi parimet që lidhen me pyetjet e ligjit të së drejtës së autorit në fushën e televizionit satelitor dhe kabllor

1985

- Rekomandimi Rec(85)8 mbi ruajtjen e trashëgimisë së filmit evropian
- Rekomandimi Rec(85)6 mbi ndihmën për krijimin artistik

1984

- Rekomandimi Rec(84)22 mbi shfrytëzimin e kapaciteteve satelitore për televizion dhe radio
- Rekomandimi Rec(84)17 mbi barazinë midis grave dhe burrave në media
- Rekomandimi Rec(84)3 mbi parimet e reklamave televizive

1982

- Deklarata mbi lirinë e shprehjes dhe informimit (29 prill 1982)

1981

- Rekomandimi Rec(81)19 mbi aksesin në informacionin e mbajtur nga autoritetet publike

1980

- Rekomandimi Rec(80)1 mbi sportin dhe televizionin

1979

- Rekomandimi Rec(79)1 në lidhje me edukimin si konsumatorë të të rriturve dhe informacionin e kon-

sumatorit

1974

- Rezoluta Res(74)43 mbi përqendrimet e shtypit
- Rezoluta Res(74)26 mbi të drejtën e përgjigjes - Pozita e individit në lidhje me shtypin

1970

- Rezoluta Res(70)19 mbi përdorimet arsimore dhe kulturore të radios dhe televizionit në Evropë dhe marrëdhëniet në këtë drejtim ndërmjet autoriteteve publike dhe organizatave të transmetimit

1967

- Rezoluta Res(67)13 mbi shtypin dhe mbrojtjen e të rinjve

1961

- Rezoluta Res(61)23 mbi shkëmbimin e programeve televizive

ASAMBLEJA PARLAMENTARE E KËSHILLIT TË EVROPËS

- Rekomandimi 1950 (2011) "Mbrotjtja e burimeve të gazetareve"
- Rekomandimi 1897 (2010) "Respekti për lirinë e mediave"
- Rekomandimi 1882 (2009) "Promovimi i internetit dhe shërbimeve të mediave në rrjet të përshtatshme për të miturit"
- Rekomandimi 1878 (2009) "Financimi i transmetimit të shërbimit publik"
- Rekomandimi 1855 (2009) "Rregullimi i shërbimeve mediatike audio-vizuale"
- Rezoluta 1636 dhe Rekomandimi 1848 (2008) "Treguesit për mediat në një demokraci"
- Rekomandimi 1836 (2008) "Realizimi i potencialit të plotë të e-mësimit për arsimin dhe trajnimin"
- Rezoluta 1577 dhe Rekomandimi 1814 (2007) "Drejt dekriminalizimit të shpifjes"
- Rekomandimi 1805 (2007) "Blasfemia, fyerjet fetare dhe gjuha e urrejtjes kundër personave në bazë të fesë së tyre"
- Rezoluta 1557 dhe Rekomandimi 1799 (2007) "Imazhi i gruas në fushën publicitare"
- Rekomandimi 1789 (2007) "Arsimi profesional dhe trajnimi i gazetareve"
- Rezoluta 1535 dhe Rekomandimi 1783 (2007) "Kërcënimet ndaj jetës dhe lirisë së shprehjes së gazetareve"
- Rekomandimi 1773 (2006) "Udhëzimet e vitit 2003 mbi përdorimin e gjuhëve të pakicave në mediat elektronike dhe standardet e Këshillit Evropës: nevoja për të rritur bashkëpunimin dhe sinergjinë me OSBE"
- Rekomandimi 1768 (2006) "Imazhi i azilkërkuesve, migrantëve dhe refugjatëve në media"
- Rezoluta 1510 (2006) "Liria e shprehjes dhe respekti për besimet fetare"
- Rekomandimi 1706 (2005) "Media dhe terrorizmi"
- Rezoluta 1438 dhe Rekomandimi 1702 (2005) "Liria e shtypit dhe kushtet e punës së gazetareve në zonat e konfliktit"
- Rezoluta 1387 (2004) "Monopolizimi i mediave elektronike dhe abuzimi i mundshëm i fuqisë në Itali"
- Rekomandimi 1641 (2004) "Transmetimi i shërbimeve publike"
- Rekomandimi 1589 (2003) "Liria e shprehjes në media në Evropë"
- Rezoluta 1313 (2003) "Bashkëpunimi kulturor midis Evropës dhe vendeve të jugut të Mesdheut"
- Rekomandimi 1586 (2002) "Ndarja dhe edukimi digjital"
- Rekomandimi 1555 (2002) "Imazhi i gruas në media"
- Rekomandimi 1543 (2001) "Racizmi dhe ksenofobia në hapësirën kibernetike"
- Rekomandimi 1506 (2001) "Liria e shprehjes dhe informimit në media në Evropë"
- Rekomandimi 1466 (2000) "Edukimi mediatik"
- Rekomandimi 1407 (1999) "Media dhe dhe kultura demokratike"
- Rezoluta 1191 (1999) "Shoqëria e informacionit dhe një botë digjitale"
- Rezoluta 1165 (1998) "E drejta për privatësi"
- Rezoluta 1142 (1997) "Parlamentet dhe mediat"
- Rekomandimi 1332 (1997) "Aspektet shkencore dhe teknike të teknologjive të reja të informacionit dhe komunikimit"
- Rezoluta 1120 (1997) "Ndikimi i teknologjive të reja të informacionit dhe komunikimit në demokraci"
- Rekomandimi 1314 (1997) "Teknologjitë e reja dhe punësimi"
- Rekomandimi 1277 (1995) "Migrantët, minoritetet etnike dhe mediat"
- Rekomandimi 1276 (1995) "Fuqia e imazhit vizual"
- Rekomandimi 1265 (1995) "Zgjerimi dhe bashkëpunimi kulturor evropian"
- Rekomandimi 1228 (1994) "Rrjete kablllore dhe stacionet televizive lokale: rëndësia e tyre për Evropën e Madhe"
- Rekomandimi 1216 (1993) "Bashkëpunimi kulturor evropian"
- Rezoluta 1003 dhe Rekomandimi 1215 (1993) "Etika e gazetarisë"

- Rekomandimi 1147 (1991) "Përgjegjësia parlamentare për reformën demokratike të transmetimit"
- Rezoluta 957 (1991) "Situata e radios lokale në Evropë"
- Rezoluta 956 (1991) "Transferimi i teknologjisë në vende të Evropës Qendrore dhe Lindore"
- Rekomandimi 1136 (1990) "Një politikë Evropiane për alkoolin"
- Rekomandimi 1122 (1990) "Ringjallje e fshatit me anë të teknologjisë së informacionit"
- Rezoluta 937 (1990) "Telekomunikacionet: implikimet për Evropën"
- Rekomandimi 1110 (1989) "Mësimi në distancë"
- Rekomandimi 1098 "Bashkëpunimi audio-vizual Lindje-Perëndim" (1989)
- Rekomandimi 1096 (1989) "Konventa Evropiane për Televizionin Ndërkufitar"
- Rekomandimi 1077 (1988) "Qasja në media ndërkufitare audio-vizuale gjatë fushatave zgjedhore"
- Rekomandimi 1067 (1987) "Dimensioni kulturor i transmetimit në Evropë"
- Rekomandimi 1059 (1987) "Ekonomia e kulturës"
- Rekomandimi 1047 (1986) "Rreziqet e boksit"
- Rekomandimi 1043 (1986) "Trashëgimia gjuhësore dhe letrare e Evropës"
- Rekomandimi 1037 (1986) "Mbrojtja e të dhënave dhe lirisë së informacionit"
- Rezoluta 848 (1985) "Privatësia e zërit dhe liria individuale e zgjedhjes muzikore"
- Rekomandimi 1011 (1985) "Situata e vallëzimit profesional në Evropë"
- Rekomandimi 996 (1984) "Punë e Këshillit të Evropës në lidhje me mediat"
- Rezoluta 820 (1984) "Marrëdhëniet e parlamenteve kombëtare me mediat"
- Rekomandimi 963 (1983) "Mjetet kulturore dhe arsimore për të reduktuar dhunën"
- Rekomandimi 952 (1982) "Mjetet ndërkombëtare për të mbrojtur lirinë e shprehjes duke rregulluar reklamën komerciale"
- Rekomandimi 926 (1981) "Pyetjet e ngritura nga transmetues kabllorë, televizivë dhe nga transmetues satelitorë"
- Rekomandimi 862 (1979) "Kinemaja dhe shteti"
- Rekomandimi 834 (1978) "Kërcënimet ndaj lirisë së shtypit dhe të televizionit"
- Rekomandimi 815 (1977) "Liria e shprehjes dhe roli i shkrimtarit në Evropë"
- Rekomandimi 749 (1975) "Transmetimi Evropian"
- Rekomandimi 748 (1975) "Roli dhe menaxhimi i transmetimit kombëtar"
- Rekomandimi 747 (1975) "Përqendrimet e shtypit"
- Rekomandimi 582 (1970) "Mediat e komunikimit masiv dhe të drejtat e njeriut"
- Rezoluta 428 (1970) "Deklarata për media të komunikimit masiv dhe të drejtat e njeriut"

KONFERENCAT E MINISTRAVE TË SPECIALIZUAR TË KËSHILLIT TË EVROPËS

Konferenca e parë e Ministrave përgjegjës për Shërbimet Mediatike dhe të Komunikimit të ri të Këshillit të Evropës

(28 dhe 29 majit 2009, Reykjavik, Islandë)

Një nocion i ri i mediave?

Konferenca e 7 Ministrave Evropiane për Politikën e Mediave masive

(Kiev, Ukrainë, 10 dhe 11 mars 2005)

Integrimi dhe diversiteti: kufijtë e rinj të politikës së mediave dhe komunikimit në Evropë

Konferenca e 6 Ministrave Evropiane për Politikën e Mediave masive

(Krakov, Poloni, 15 dhe 16 qershor 2000)

Një politikë e mediave për të nesërmen

Konferenca e 5 Ministrave Evropiane për Politikën e Mediave masive

(Selanik, Greqi, 11 dhe 12 dhjetor 1997)

Shoqëria e Informacionit: një sfidë për Evropën

Konferenca e 4 Ministrave Evropiane për Politikën e Mediave masive

(Pragë, Çeki, 7 dhe 8 dhjetor 1994)

Mediat në shoqërinë demokratike

Konferenca e 3 Ministrave Evropiane për Politikën e Mediave masive

(Nikosi, Qipro, 9 dhe 10 tetor 1991)

Cila është rrugë përpara e mediave të Evropës në vitet 1990?

Konferenca e 2 Ministrave Evropiane për Politikën e Mediave masive

(Stokholm, Suedi, 23 dhe 24 nëntor 1988)

Politika Evropiane e Mediave Masive në një kontekst ndërkombëtar

Konferenca e 1 Ministrave Evropiane për Politikën e Mediave masive

(Vienë, Austri, 9 dhe 10 dhjetor 1986)

E ardhmja e televizionit në Evropë

